



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 55

Tiranë – E martë, 17 mars 2026

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 25/2026, datë 20.2.2026	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 43/2023, “Për qeverisjen elektronike”, i ndryshuar..... 3955
Dekret i Presidentit nr. 140, datë 12.3.2026	Për shpallje ligji..... 3957
Dekret i Presidentit nr. 110, datë 5.3.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 3957
Dekret i Presidentit nr. 111, datë 5.3.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 3957
Dekret i Presidentit nr. 112, datë 5.3.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 3957
Dekret i Presidentit nr. 113, datë 9.3.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 3958
Dekret i Presidentit nr. 114, datë 9.3.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 3958
Dekret i Presidentit nr. 115, datë 9.3.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 3958
Dekret i Presidentit nr. 116, datë 9.3.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 3959
Dekret i Presidentit nr. 117, datë 9.3.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 3959
Dekret i Presidentit nr. 118, datë 9.3.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 3959

Dekret i Presidentit nr. 119, datë 9.3.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	3960
Dekret i Presidentit nr. 120, datë 9.3.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	3960
Dekret i Presidentit nr. 121, datë 9.3.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	3960
Dekret i Presidentit nr. 122, datë 9.3.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	3960
Dekret i Presidentit nr. 123, datë 9.3.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	3961
Dekret i Presidentit nr. 124, datë 9.3.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	3961
Dekret i Presidentit nr. 125, datë 9.3.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	3961
Dekret i Presidentit nr. 126, datë 9.3.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	3962
Dekret i Presidentit nr. 127, datë 9.3.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	3962
Dekret i Presidentit nr. 128, datë 9.3.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	3962
Dekret i Presidentit nr. 129, datë 9.3.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	3963
Dekret i Presidentit nr. 130, datë 9.3.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	3963
Dekret i Presidentit nr. 131, datë 9.3.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	3963
Dekret i Presidentit nr. 132, datë 9.3.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	3963
Dekret i Presidentit nr. 133, datë 10.3.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	3964
Dekret i Presidentit nr. 134, datë 10.3.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	3964
Dekret i Presidentit nr. 135, datë 10.3.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	3964
Dekret i Presidentit nr. 136, datë 10.3.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	3965
Dekret i Presidentit nr. 137, datë 10.3.2026	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	3965

Dekret i Presidentit nr. 138, datë 12.3.2026	Për emërim ambasadori në detyrë.....	3965
Dekret i Presidentit nr. 139, datë 12.3.2026	Për emërim ambasadori në detyrë.....	3966
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 148, datë 11.3.2026	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 117, datë 26.2.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Rikualifikimi i hyrjes së qytetit të Shkodrës dhe bregut perëndimor të Liqenit të Shkodrës’, Bashkia Shkodër”.....	3966
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 149, datë 11.3.2026	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 206, datë 6.4.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Përfundimi i punimeve të mbetura dhe plotësimi me rrugë dytësore, Nyja e Milotit’”	3968
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 151, datë 11.3.2026	Për përcaktimin e standardeve, që kanë të bëjnë me kushtet teknike të sistemit të basteve sportive <i>online</i> , duke përfshirë, por pa u kufizuar, në identifikimin dhe regjistrimin e lojtarëve, kërkesat e programeve <i>software</i> dhe <i>hardware</i> , certifikimin e sistemit, procedurat lidhur me faturat dhe transaksionet e pagesave, parimet e sigurisë dhe kushtet e kontrollit apo të mbikëqyrjes.....	3970
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 152, datë 11.3.2026	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 566, datë 29.7.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së organizatave rinore dhe organizatave për të rinjtë, që përfitojnë financime nga fondet grant nga buxheti i shtetit, të dedikuara për rininë”	3978
Urdhër i përbashkët i ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit dhe i ministrit të Arsimit nr. 81, datë 30.1.2026	Për ngritjen dhe përbërjen e Komitetit Sektorial të Bujqësisë.....	3981
Urdhër i ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit nr. 156, datë 4.3.2026	Për disa ndryshime në urdhrin nr. 99, datë 25.5.2021, “Për miratimin e Katalogut Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale”, i ndryshuar....	3981
Urdhër i ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit nr. 192, datë 10.3.2026	Për delegim kompetencash.....	3985
Urdhër i ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit nr. 193, datë 10.3.2026	Për delegim kompetencash.....	3985
Urdhër i ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit nr. 194, datë 10.3.2026	Për delegim kompetencash.....	3985
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 14, datë 17.2.2026	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2025-13, datë 14.1.2025, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.....	3986



LIGJ
Nr. 25/2026

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË LIGJIN NR. 43/2023, “PËR
QEVERISJEN ELEKTRONIKE”,
I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 81 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozim të një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 43/2023 “Për qeverisjen elektronike”, i ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 4 bëhet ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

1. Pika 21 shfuqizohet.

2. Pas pikës 47 shtohet pika 48 me këtë përmbajtje:

“48. “Shoqëri operatore TIK” është shoqëri aksionere, ku shteti zotëron të paktën 51 për qind të aksioneve për zhvillimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve, platformave dhe infrastrukturave të ofrimit të shërbimeve elektronike.”.

Neni 2

Në nenin 12 pas paragrafit të parë shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

“Në çdo rast të përpunimit të të dhënave personale ndërmerren dhe zbatohen masat e duhura teknike dhe organizative, duke garantuar një nivel sigurie të përshtatshëm ndaj rrezikut, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Çdo veprim përpunimi i të dhënave personale gjatë aksesit/ndërveprimit me bazat e të dhënave shtetërore realizohet në përputhje me legjislacionin specifik dhe legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Rolet mbi kontrollin dhe përpunimin e të dhënave personale do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave në zbatim të këtij ligji.”.

Neni 3

Në nenin 22, pika 4, pas togfjalëshit “urdhër të Kryeministrit” shtohet togfjalëshi “apo ministrit përgjegjës për qeverisjen elektronike.”.

Neni 4

Në nenin 23 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Fjalja e parë, e pikës 1, ndryshohet si më poshtë:

“AKSHI është institucion i administratës shtetërore, me statusin e personit juridik publik buxhetor me seli në Tiranë, në varësi të Kryeministrit apo ministrit përgjegjës për qeverisjen elektronike, sipas përcaktimit me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

2. Në fund të pikës 1 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“AKSHI mund të themelojë “Shoqëri Operatore TIK” sipas parashikimeve të këtij ligji.”.

3. Në pikën 2 fjala “Kryeministria” hiqet.

Neni 5

Në nenin 24, pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Për ushtrimin e funksioneve operative të zhvillimit, administrimit dhe mirëmbajtjes së sistemeve TIK, AKSHI mund të krijojë, të marrë pjesë ose të bashkëpunojë me shoqëri aksionere ku shteti zotëron të paktën 51 përqind të aksioneve, si dhe t’u kalojë atyre në administrim sisteme, platforma ose infrastruktura TIK dhe/ose t’i ngarkojë për zhvillimin dhe operimin e tyre nga fillimi.

Në çdo rast, kompetencat rregullatore, autoriteti publik dhe përgjegjësia institucionale mbeten tek AKSHI.”.

Neni 6

Në nenin 25, pika 1, shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:

“b) ofron shërbime të përqendruara të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për institucionet dhe organet e administratës shtetërore



nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, si edhe për institucione të tjera publike, me kërkesë të vetë institucionit, drejtpërdrejt ose nëpërmjet shoqërive operatore TIK, sipas legjislacionit në fuqi.”.

Neni 7

Në nenin 26, pas shkronjës “j” shtohet shkronja “k” me këtë përmbajtje:

“k) ushtrimi i detyrave të parashikuara në shkronjat “c”, “d”, “dh”, “f” dhe “g” të këtij neni mund të realizohet nga AKSHI, drejtpërdrejt ose nëpërmjet shoqërive operatore TIK në përputhje me këtë ligj.

Në çdo rast autoriteti rregullator, përgjegjësia institucionale, si dhe pronësia mbi sistemet, infrastrukturën, kodin burimor dhe të dhënat mbeten të shteti dhe administrohen nga AKSHI.”.

Neni 8

Pas nenit 26 shtohet neni 26/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 26/1

Kalimi në administrim i sistemeve dhe infrastrukturave TIK

Me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të AKSHI-t, sisteme, platforma ose infrastruktura TIK ose pjesë të tyre mund t'u kalohen në administrim shoqërive operatore TIK për qëllime zhvillimi, operimi ose mirëmbajtjeje.

Kalimi në administrim nuk sjell transferim të pronësisë mbi këto sisteme dhe infrastruktura.”.

Neni 9

Në nenin 29 bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

1. Shkronjat “dh”, “e” dhe “ë” shfuqizohen.

2. Pas shkronjës “h” shtohet shkronja “i” me këtë përmbajtje:

“i) i propozon Këshillit të Ministrave kalimin në administrim për qëllim zhvillimi, operimi apo mirëmbajtjeje të infrastrukturës së ofrimit të shërbimeve elektronike tek “Shoqëria Operatore TIK”.”.

3. Pas shkronjës “j” shtohet shkronja “j” me këtë përmbajtje:

“j) procedurat e prokurimit publik, përfshirë ato në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), zhvillohen në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për prokurimin publik dhe prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.”.

Neni 10

Në nenin 32, pika 1, në fjalinë e parë pas togfjalëshit “me urdhër të Kryeministrit” shtohet togfjalëshi “apo ministrit përgjegjës për qeverisjen elektronike”.

Neni 11

Në nenin 33, në pikën 4, pas togfjalëshit “nga Kryeministri” shtohet togfjalëshi “apo ministri përgjegjës për qeverisjen elektronike”.

Neni 12

Në nenin 34, në fund të fjalisë së parë shtohet shprehja “në masën deri në 800 000 (tetëqind mijë) lekë në muaj.”.

Neni 13

Në nenin 36 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Pagesat që institucionet publike përfituese kryejnë ndaj shoqërive operatore TIK, në bazë kontratash shërbimi, nuk përbëjnë tarifa publike dhe rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 14

Dispozita kalimtare

Procedurat e prokurimit të nisura përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji do të vijojnë të realizohen sipas parashikimeve të ligjit në fuqi në momentin e fillimit/nisjes së tyre.

Neni 15

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të rishikojë dhe, sipas rastit, të përshtatë aktet nënligjore në fuqi për zbatimin e tij.



Neni 16
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 20.2.2026.

Shpallur me dekretin nr. 140, datë 12.3.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET
Nr. 140, datë 12.3.2026

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 25/2026, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 43/2023, “Për qeverisjen elektronike”, i ndryshuar”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET
Nr. 110, datë 5.3.2026

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, e nenit 93 të Kushtetutës; neneve 8, 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ

Neni 1

Dhënen e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Santolo Nunzio Petrone

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET
Nr. 111, datë 5.3.2026

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, e nenit 93 të Kushtetutës; neneve 16, 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënen e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Pavlo Andrea Sidheri

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET
Nr. 112, datë 5.3.2026

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, e nenit 93 të Kushtetutës; neneve 8, 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,



DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Güven Cevat Sakli

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 113, datë 9.3.2026

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Bledar Musa Nguci
2. Florenc Tofik Spahiu

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 114, datë 9.3.2026

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Rezarta Pajtim Ajazaj
2. Blerti Kujtim Elbasani

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 115, datë 9.3.2026

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Silvana Ali Kala-Schülpen
2. Geraldina Mirash Zaganjori



Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 116, datë 9.3.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetasve:

1. Juliana Dhimiter Prifti

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 117, datë 9.3.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Dritan Bekim Haskaj
2. Xhulio Pelivan Bakui

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 118, datë 9.3.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Merita Risa Sulollari
2. Renis Edmond Muçaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

**DEKRET****Nr. 119, datë 9.3.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Skënder Beq Kasemi
2. Alban Pal Ndoj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 120, datë 9.3.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Edmond Nikollaq Rista
2. Mehmet Durim Tusha

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 121, datë 9.3.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Gleni Maksim Lamani
2. Gazmend Namik Feraizi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 122, datë 9.3.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,



DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Melsi Refki Seferi
2. Eliane Kelmend Lamnica

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 123, datë 9.3.2026

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6, 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Skënder Elmi Ukaj
2. Andi Ramiz Ukaj
3. Visar Ismen Vilaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 124, datë 9.3.2026

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6, 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Sylejman Ali Agaj
2. Albana Ali Agaj Salihaj
3. Raza Brahim Agaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 125, datë 9.3.2026

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Merita Koçi Floqi
2. Anisa Safet Xhaferaj



Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 126, datë 9.3.2026

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetasve:

1. Florinde Mark Lleshi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 127, datë 9.3.2026

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Nico Mejtim Kojku
2. Amatea Gazment Sauer-Tabaku

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 128, datë 9.3.2026

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Alvia Albert Dervishaj
2. Aleksandër Jani Isaia
3. Elvira Dhimitri Bahtiri
4. Elda Irakli Stegmüller

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj



DEKRET
Nr. 129, datë 9.3.2026

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Mustafa Kamber Shabani
2. Lea Emil Frenzke
3. Krisel Nikolla Kota

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 130, datë 9.3.2026

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Myzejene Vesel Johansen
2. Zamir Ruzhdi Peshkopia
3. Blendi Agim Qesaraku

4. Bujana Xhemil Spahija

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 131, datë 9.3.2026

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Fatbardha Dhimitër Kameraj
2. Enkeleda Petrit Olldashi-Heusinger

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 132, datë 9.3.2026

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,



DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Altin Xhemali Braneshi
2. Arben Hasim Duzha

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 133, datë 10.3.2026

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; të neneve 9, 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, të ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetas:

1. Kathryn Hallie Alan Jack Zimmerman

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 134, datë 10.3.2026

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; të neneve 9, 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, të ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetas:

1. Meg Joelle Brian Alexander Headley

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 135, datë 10.3.2026

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; të neneve 16, 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, të ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Arjan Jusuf Mullahi
2. Megi Genci Gambeta



Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 136, datë 10.3.2026

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; të neneve 16, 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, të ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Gledis Leonard Lushaj
2. Saimir Muharem Patogu

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 137, datë 10.3.2026

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; të neneve 13, 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, të ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

I lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetasve:

1. Elisabeta Aqif Ollogu

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 138, datë 12.3.2026

**PËR EMËRIM AMBASADORI NË
DETYRË**

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “dh”, nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 26, pika 2, të ligjit nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zonja Jeta Kreka emërohet Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqplotë i Republikës së Shqipërisë në Shtetin e Katarit, rezident.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

**DEKRET****Nr. 139, datë 12.3.2026****PËR EMËRIM AMBASADORI NË
DETYRË**

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “dh”, nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 26, pika 2, të ligjit nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Zoti Bardhyl Kollçaku emërohet Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqplotë i Republikës së Shqipërisë në NATO, rezident.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

VENDIM**Nr. 148, datë 11.3.2026**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 117, DATË 26.2.2025,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA
REALIZIMI I PROJEKTIT
‘RIKUALIFIKIMI I HYRJES SË QYTETIT
TË SHKODRËS DHE BREGUT
PERËNDIMOR TË LIQENIT TË
SHKODRËS’, BASHKIA SHKODËR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 117, datë 26.2.2025, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikat 3 dhe 4, vlera “... 402 403 347 (katërqind e dy milionë e katërqind e tre mijë e treqind e dyzet e shtatë) lekësh ...” zëvendësohet me vlerën “... 405 986 166 (katërqind e pesë milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekësh ...”;

b) Të dhënat për shpronësim të numrit rendor 21 të tabelës bashkëlidhur vendimit zëvendësohen me të dhënat me të njëjtin numër rendor, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi;

c) Tabelës bashkëlidhur vendimit i shtohet pasuria me numër rendor 26, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpenzimet procedurale shtesë, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga buxheti i Bashkisë Shkodër.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave, Bashkia Shkodër, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Shkodër dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**



TABELA E NDRYSHIMEVE DHE SHITESAVE NË LISTËN E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË TË CILËVE SHPRONËSOHEN ME VENDIMIN NR. 117, DATË 26.2.2025, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIM PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI ‘RIKUALIFIKIMI I HYRJES SË QYTETIT TË SHKODRËS DHE BREGUT PERËNDIMOR TË LIQENIT TË SHKODRËS’”

Nr. rendor	Pronari			Të dhëna kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)								Vlerësimet për shpronësim												Vlera totale (lekë)	Shënime (kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.)
												Livadh			Truall			Ndërtesë social-ekonomike, vlerësuar me preventiv punimesh			Ndërtesë banimi				
	Emri	Atësia	Mbiemri	Qyteti	Zona. kadastrale	Indeksi i hartës	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale (m²)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë / m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë / m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë / m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë / m²)	Vlera (lekë)		
21	Fatmir	Xhezair	Muça	Shkodër	8591	R-4	18/816	Truall	5828	63	134				5,828	8,511	49,602,108							49,602,108	
26	Arben Klodiana Cuf Elona	Teufik Hekuran Hekuran	Dibra Molika Dibra Dibra	Shkodër	8591	R-4	18/42-ND	Ndërtesë	545.8	63	158							546		20,111,181				20,111,181	
VLERA TOTALE E SHPRONËSIMIT																	49,602,108			20,111,181				69,713,289	
Efekti financiar shtesë është 3,582,819 lekë																									

**VENDIM****Nr. 149, datë 11.3.2026**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 206, DATË 6.4.2022,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT ‘PËRFUNDIMI I PUNIMEVE
TË MBETURA DHE PLOTËSIMI ME
RRUGË DYTËSORE, NYJA E MILOTIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 206, datë 6.4.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Përfundimi i punimeve të mbetura dhe plotësimi

me rrugë dytësore, Nyja e Milotit””, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikat 3 dhe 4, vlera “... 16 659 775.50 (gjashtëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë pikë pesëdhjetë) lekësh ...” zëvendësohet me “... 17 282 495.50 (shtatëmbëdhjetë milionë e dyqind e tetëdhjetë e dy mijë e katërqind e nëntëdhjetë e pesë pikë pesëdhjetë) lekësh ...”;

b) Tabelës bashkëlidhur vendimit i shtohet tabela, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vlera shtesë, prej 622 720 (gjashtëqind e njëzet e dy mijë e shtatëqind e njëzet) lekësh, përballohet nga buxheti i shtetit, llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.

3. Shpenzimet procedurale shtesë, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

4. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Lezhë, Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Lezhë dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**



LISTA SHITESË E PRONARËVE, PASURIA E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, E TË CILËVE SHPRONËSOHET ME VENDIMIN NR. 206, DATË 6.4.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT ‘PËRFUNDIMI I PUNIMEVE TË MBETURA DHE PLOTËSIMI ME RRUGË DYTËSORE, NYJA E MILOTTI’”

Nr.	Pronari			Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)				Sipërfaqja që shpronësohet						Objekti që shpronësohet				Vlera totale (lekë)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Sip. totale	Lloji pasurisë	Tokë “truall”			Tokë “arë”			Banim		Soc.-ek.			
								Sipërfaqja e shpronësuar (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera lekë	Sipërfaqja e shpronësuar (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera lekë	Sipërfaqja e shpronësuar (m²)	Vlera lekë	Sipërfaqja e shpronësuar (m²)	Vlera lekë		
82	Kujtim Sinan Lule Lindita Besim	Baftjar Baftjar Baftjar Baftjar Baftjar	Isufi Isufi Tuga Hidri Isufi	3441	5/15	3,200	Arë				2240	278	622,720					622,720	
	SHUMA TOTALE																	622,720	



VENDIM

Nr. 151, datë 11.3.2026

**PËR PËRCAKTIMIN E STANDARDEVE,
QË KANË TË BËJNË ME KUSHTET
TEKNIKE TË SISTEMIT TË BASTEVE
SPORTIVE *ONLINE*, DUKE
PËRFSHIRË, POR PA U KUFIZUAR, NË
IDENTIFIKIMIN DHE REGJISTRIMIN
E LOJTARËVE, KËRKESAT E
PROGRAMEVE *SOFTWARE* DHE
HARDWARE, CERTIFIKIMIN E
SISTEMIT, PROCEDURAT LIDHUR ME
FATURAT DHE TRANSAKSIONET E
PAGESAVE, PARIMET E SIGURISË DHE
KUSHTET E KONTROLLIT
APO TË MBIKËQYRJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 24, të ligjit nr. 155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Ky vendim ka për qëllim përcaktimin e standardeve, që kanë të bëjnë me kushtet teknike dhe standardet minimale, që duhet të plotësojnë sistemet/*website*-t/aplikacionet e basteve sportive *online* të subjekteve të licencuara, të cilat konsistojnë në:

a) kërkesat teknike minimale, që duhet të plotësojnë sistemet, ku administrohen, menaxhohen dhe luhen bastet sportive *online*, duke përfshirë komponentët *hardware* dhe *software*;

b) kërkesat për identifikimin e regjistrimin e lojtarëve, me qëllim sigurimin e aksesit të ligjshëm, mbrojtjen e të dhënave dhe parandalimin e lojës së paligjshme;

c) procedurat në lidhje me faturat dhe transaksionet e pagesave, duke siguruar që çdo transaksion të regjistrohet e të monitorohet në kohë reale nga organet përkatëse;

ç) procedurat lidhur me faturat dhe transaksionet e pagesave;

d) certifikimin e sistemit.

**II. KËRKESAT MINIMALE QË DUHET TË
PËRMBUSHË PLATFORMA, KU DO TË
ADMINISTROHEN, MENAXHOHEN DHE
LUHEN BASTET SPORTIVE *ONLINE***

1. Sistemi qendror (*BackEnd*)

1.1. Arkitektura e përgjithshme

a) Sistemi duhet të ndërtohet bazuar në një arkitekturë me mikrosërbbime për modularitet, shkallëzim e mirëmbajtje të lehtë;

b) Arkitektura e sistemit duhet të disponojë shpërndarës ngarkese (*load balancer*) për shpërndarjen e trafikut ndërmjet instancave të aplikacionit;

c) Arkitektura duhet të operojë, duke u bazuar në ngjarje (*event-driven*) për përpunimin e basteve “*live*” dhe të rezultateve në kohë reale;

ç) Arkitektura e sistemit duhet të disponojë shtresë kujtese të përkohshme (*caching*) për uljen e ngarkesës në bazën e të dhënave;

d) Arkitektura e sistemit duhet të ofrojë mundësi për shkallëzim horizontal e vertikal, në varësi të ngarkesës së përdoruesve.

1.2 Shërbimet kryesore:

a) Shërbimi i përdoruesve:

i. sistemi duhet të ketë të implementuar mekanizma, që mundësojnë regjistrimin, hyrjen (*login*) dhe menaxhimin e profileve të përdoruesve;

ii. sistemi duhet të ketë të implementuar mekanizma për autentifikimin dhe autorizimin me role (minimalisht duhet të përfshijë rolet: përdorues, operator, administrator, auditues);

iii. sistemi duhet të ketë të implementuar mekanizma për gjurmim të çdo veprimi të përdoruesit dhe të mundësojë ruajtjet e historikut të veprimeve;

b) Shërbimi i basteve:

i. sistemi duhet të ofrojë mundësinë për krijim e përpunim bastesh të vetme dhe të shumëfishta;

ii. sistemi duhet të ketë të implementuar mekanizma kontrolli për kufijtë financiarë dhe rregullat e lojës;

iii. sistemi duhet të disponojë algoritme të posaçme për llogaritje të fitimeve;

iv. në rast se organizatori i licencuar do të implementojë algoritme të bazuara në inteligjencën artificiale për shërbimin e basteve, në çdo rast në ndërfaqen *web* dhe/ose aplikacionin për përdoruesit duhet të jetë e publikuar logjika e algoritmit të implementuar për arsye transparence. Në çdo rast, çdo mjet i inteligjencës artificiale, që do të implementohet, duhet të jetë në përputhje me



përcaktimet ligjore në Republikën e Shqipërisë dhe *EU AI Act*;

v. sistemi duhet të mundësojë marrje të dhënash nga palë të treta, siç mund të jenë ofrues të shërbimeve të kuotimit të jashtëm;

vi. sistemi duhet të mundësojë përditësim në kohë reale të ngjarjeve dhe të rezultateve;

c) Raportim dhe analiza:

i. sistemi duhet të ofrojë raporte me të dhëna reale dhe të azhurnuara për aktivitetin financiar, përdoruesit, fitimet dhe ngjarjet e vendosura, raporte të detajuara të bilancit të lojtarëve, raporte të pagesave dhe të tërheqjeve;

ii. sistemi duhet të ketë mekanizma të integruar për monitorimin e raportimin e aktivitetit të bastit, duke përfshirë raportet e të ardhurave, transaksioneve, statistikave të lojërave, raportet e rrezikut, bonuseve dhe promocioneve, si dhe identifikimin e sjelljeve të pazakonta të përdoruesve;

iii. raportimi duhet të përfshijë të ardhurat bruto nga bastet, fitimet neto, numrin e basteve të vendosura dhe raportet e dyshimeve për pastrim parash apo aktivitet të parregullt;

iv. sistemi duhet të sigurojë raportimin automatik për nevojat e rregullatorit. Kjo përfshin raportimin e transaksioneve të dyshimta dhe basteve të dyshimta, raportimin e detyrimeve fiskale, si dhe mekanizma të mbrojtjes së lojtarëve, në përputhje me kuadrin ligjor të lojërave të fatit në Shqipëri;

ç) Sistemi duhet:

i. të jetë i aftë t'u ofrojë lojtarëve një histori të transaksioneve të lojërave;

ii. të jetë i aftë t'u ofrojë lojtarëve një histori të transaksioneve financiare, duke përfshirë totalin e depozitave, tërheqjeve, fitimeve/humbjeve dhe pozicionin neto total;

iii. të ofrojë informacion të detajuar për çdo lojë;

iv. të shfaqë emrin e çdo loje;

v. të komunikojë kufizimet në lojë;

vi. të ofrojë udhëzime mbi mënyrën e lojës;

vii. të ofrojë një tabelë pagesash për të gjitha shpërblimet dhe funksionet/skenarët e veçantë të lojës;

viii. të shfaqë bilancin aktual të llogarisë së lojtarit;

ix. të shfaqë në çdo kohë bilancin e llogarisë së lojtarit dhe monedhën përkatëse;

x. të japë informacion për mbrojtjen e lojtarit dhe rrezikun e lojërave të fatit;

d) Siguria:

i. sistemi duhet të mundësojë komunikim të sigurt me *HTTPS/TLS 1.3* ose ekuivalent;

ii. sistemi duhet të mundësojë kodim të fjalëkalimeve me *bcrypt*, *argon2*;

iii. sistemi duhet të ketë të implementuar mekanizma për menaxhimin e përdoruesve dhe të *login*-it të tyre, sipas roleve (RBAC);

iv. sistemi duhet të ketë të implementuar mekanizma automatikë për kufizim të kërkesave për mbrojtje nga sulmet *DDoS* ose të ngjashme dhe validim të *login*-eve për mbrojtje nga *SQL Injection*, *XSS* ose të ngjashme;

v. Sistemi duhet të ketë të integruar mekanizma, që detyrojnë përdorimin e një niveli të lartë të kompleksitetit të fjalëkalimeve, të cilat duhet të plotësojnë minimalisht kushtet e mëposhtme:

- Fjalëkalimi duhet të jetë i përbërë nga të paktën 9 (nëntë) karaktere të kombinuara alfanumerike e speciale dhe janë miksim “*lowercase*” dhe “*uppercase*”;

- Fjalëkalimi nuk duhet të jetë i njëjtë me emrin e llogarisë;

- Nëse fjalëkalimi ndryshohet, fjalëkalimi i ri duhet të jetë i ndryshëm nga të paktën 3 (tri) fjalëkalimet e fundit të përdorura për llogarinë.

1.3 Regjistrimi i përdoruesit, identifikimi dhe menaxhimi i llogarisë:

a) Sistemi duhet të ofrojë një proces të lehtë dhe të sigurt të regjistrimit të përdoruesit;

b) Sistemi duhet të ketë një modul të centralizuar për menaxhimin e identitetit e të aksesit;

c) Çdo përdorues, administrator, operator apo agjent duhet të ketë identitet unik dhe kredenciale të personalizuar;

ç) Sistemi duhet të zbatojë mekanizma bllokimi pas 5 (pesë) përpjekjeve të dështuara;

d) Sesionet e përdoruesit duhet të skadojnë automatikisht pas një periudhe mosveprimi nga përdoruesi. Kjo periudhë nuk duhet të jetë më e gjatë se 60 (gjashtëdhjetë) minuta;

dh) Sistemi nuk duhet të regjistrojë asnjë përdorues, nëse nuk janë vendosur të dhënat: emër, mbiemër, datëlindje, adresë, dokument identifikimi i skanuar, adresë *email*-i, numër telefoni. Në mënyrë që përdoruesi të konfirmohet dhe të ketë mundësinë të përdorë sistemin, duhet të kryhet verifikimi i tij nëpërmjet adresës së *email*-it ose numrit të telefonit të vendosur nga përdoruesi gjatë regjistrimit për të verifikuar identitetin e përdoruesit dhe për të minimizuar rrezikun e krijimit të llogarive të rreme;



e) Identifikimi bëhet me fjalëkalim të fortë, autentifikim me 2 (dy) faktorë dhe verifikim të moshës ligjore të përdoruesit;

ë) Sistemi duhet të ketë të integruar mekanizma të leximit të dokumentit të skanuar (dokument identifikimi) dhe, nëpërmjet tij, të sigurojë ligjshmërinë e përdoruesit për t'u regjistruar sipas moshës minimale të përcaktuar në legjislacionin shqiptar;

f) Në rast se zbulohet një aktivitet i dyshimtë ose i paautorizuar në llogarinë e një përdoruesi, duhet të ketë mekanizma për raportim e ndërhyrje të menjëhershme për të parandaluar shfrytëzimin e llogarisë dhe për të siguruar llogarinë e përdoruesit;

g) Në rast se në sistem do të aplikohen politika të çaktivizimit automatik të llogarive, ato nuk duhet të çaktivizohen në asnjë rast pa njoftuar përdoruesin të paktën 30 (tridhjetë) ditë përpara çaktivizimit të llogarisë;

gj) Përdoruesit nuk duhet të jenë në gjendje të krijojnë më shumë se një llogari aktive për çdo identitet të verifikuar. Çdo tentativë për hapje të shumëfishtë duhet të sinjalizohet automatikisht në sistemin qendror të monitorimit *online* (SQMO) të administruar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit (AMLF);

h) Platforma duhet të ruajë dhe të përditësojë automatikisht statusin e identifikimit të përdoruesit ("verifikuar"/"në pritje"/"bllokuar"), duke siguruar që asnjë përdorues i paidentifikuar plotësisht të mos ketë akses në lojëra apo në transaksione.

1.4 Integrimi me sisteme të treta:

a) Sistemi i basteve sportive *online* duhet të jetë ndërtuar në mënyrë që të garantojë ndërveprueshmëri të sigurt e të qëndrueshme me sistemet e palëve të treta, të cilat janë të nevojshme për funksionimin ligjor dhe teknik të aktivitetit të lojërave të fatit;

b) Integrimi i sistemit duhet të sigurojë shkëmbimin e plotë, në kohë reale dhe të verifikueshme të të dhënave ndërmjet Autoritetit të Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit (AMLF), për qëllime kontrolli, monitorimi dhe mbikëqyrjeje të aktivitetit të basteve sportive *online*; sistemit qendror të monitorimit *online* (SQMO), për transmetimin automatik të të dhënave mbi bastet e vendosura, fitimet, pagesat, faturat dhe çdo transaksion të regjistruar nga platforma, sipas përcaktimeve ligjore; institucioneve financiare dhe agjentëve të licencuar të pagesave, për kryerjen e transaksioneve financiare

vetëm nëpërmjet kanaleve të miratuara dhe të gjurmara bankare; dhe sistemeve të administratës tatimore dhe doganore, për raportimin automatik të taksave dhe tarifave, sipas dispozitave fiskale në fuqi;

c) Sistemi duhet të lejojë komunikim të sigurt dhe transferim të dhënash të enkriptuara, duke siguruar mbrojtjen e informacionit financiar e personal të lojtarëve, në përputhje me kërkesat e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe akteve nënligjore të miratuara nga AMLF-ja;

ç) Platforma duhet të jetë teknikisht e integruar me SQMO nëpërmjet një ndërfaqeje të miratuar nga AMLF-ja, e cila garanton:

i. regjistrimin automatik të çdo bilete basti të vendosur *online*;

ii. dërgimin e menjëhershëm të të dhënave mbi pagesat dhe fitimet;

iii. pamundësinë e manipulimit, fshirjes apo ndryshimit të të dhënave pas regjistrimit;

d) Çdo sistem, që nuk përmbush kërkesat e integritetit sipas kësaj nënpike, nuk mund të konsiderohet funksional e nuk mund të përdoret për ushtrimin e aktivitetit të basteve sportive *online* në Republikën e Shqipërisë;

dh) Sistemi i basteve sportive *online*, përpara se të fillojë të jetë funksional për lojtarët, duhet të sigurojë shkëmbimin e të dhënave me sistemet e përcaktuara në këtë nënpikë, sisteme këto që nga ana tjetër e tyre duhet të respektojnë parashikimet e kuadrit rregullator në fuqi.

1.5 Mbajtja e regjistrave të ngjarjeve dhe të transaksioneve:

a) Sistemi duhet të mbajë regjistra të detajuar për të gjitha ngjarjet e transaksionet, që ndodhin në platformë;

b) Përdoruesit duhet të kenë role të përcaktuara dhe privilegje të kontrolluara për të aksesuar e për të vepruar;

c) Veprimet e përdoruesve, si: vendosja e basteve, transferimet e fondeve dhe ndryshimet e llogarive duhet të regjistrohen dhe të jenë të lidhura me identifikimin e tyre unik;

ç) Sistemi duhet të ketë të implementuar mekanizma, që mundësojnë ruajtjen e regjistrave në mënyrë të sigurt dhe mbrojtjen nga akseset e paautorizuara;

d) Sistemi duhet të ketë mekanizma për auditimin e monitorimin e regjistrave për të identifikuar dhe ndjekur aktivitetet e paligjshme ose të dyshimta;



dh) Ky auditim duhet të përfshijë shënime të detajuara të veprimeve të përdoruesve dhe të ndërveprimeve me regjistrat;

e) Sistemi duhet të ketë të implementuar mekanizma gjurmimi dhe auditimi për çdo ndryshim që ndodh në sistem dhe për çdo veprim të kryer nga përdoruesit. Gjurmët e veprimeve dhe të auditimit duhet të jenë të pamundura për t'u ndryshuar. Në gjurmët (*logs*) duhet të ruhen minimalisht të dhënat: numri i letërnjoftimit të përdoruesit ose të administratorit, data/ora, IP-ja e pajisjes, veprimi i kryer dhe statusi i veprimit. *Log*-et mund të arkivohen, por, në asnjë rast, nuk duhet të fshihen;

ë) Çdo incident raportohet brenda 24 (njëzet e katër) orëve pranë autoriteteve mbikëqyrëse;

f) Të dhënat e *log*-eve të rrjetit duhet të ruhen minimalisht për 5 (pesë) vjet, në mënyrë që të jenë të disponueshme për auditim nga AMLF-ja;

g) Monitorimi duhet të jetë aktiv 24/7 dhe të gjenerojë njoftime automatike për anomalitë, ndërprerjet ose aktivitetet e dyshimta.

1.6 Baza e të dhënave:

a) Baza e të dhënave duhet të ketë minimalisht formatin “*Replikim master-slave*” për siguri dhe performancë;

b) Në çdo kohë të aktivitetit të platformës duhet të ketë kopje rezervë automatike dhe politika ruajtjeje. Kopjet rezervë duhet të jenë të enkriptuara dhe të plotësojnë standardin 3-2-1 (një kopje primare dhe dy kopje rezervë. Kopjet rezervë duhet të jenë në dy media/teknologji të ndryshme). Në çdo rast, një nga kopjet e *backup*-it duhet të jetë në distancë minimalisht 50 km nga kopja primare;

c) Baza e të dhënave duhet të mundësojë enkriptim në pushim (*at rest*), minimalisht me AES-256 ose ekuivalent, dhe enkriptim gjatë transmetimit (*in transit*), me minimalisht TLS 1.3 ose ekuivalent;

ç) Baza e të dhënave duhet të ketë të integruar mekanizmat e maskimit të të dhënave (*data masking*) për të dhëna personale (p.sh. numra telefoni, dokumente ID);

d) Të paktën një kopje e plotë e përditësuar e të gjithë bazës së të dhënave duhet të ruhet brenda territorit të vendit, ku është licencuar organizatori/subjekti;

dh) Struktura e bazës së të dhënave duhet të mundësojë:

i. historik të plotë të basteve, të fitimeve, të humbjeve, të krediteve, të bonuseve;

ii. auditim të çdo ndryshimi;

iii. integrim me API-të e autoriteteve shtetërore;

e) Baza e të dhënave duhet të ruajë *log*-e të plota të çdo operacioni: *insert, update, delete, select*;

ë) Çdo ndryshim në të dhënat e përdoruesve dhe bastet duhet të ruhet në tabela auditimi të ndara;

f) *Log*-et duhet të përmbajnë minimalisht:

i. ID-në e përdoruesit/operatorit;

ii. kohën (*timestamp UTC*);

iii. IP-në e origjinës;

iv. llojin e operacionit dhe të dhënat e prekura/ndryshuara;

g) *Log*-et duhet të jenë të pandryshueshme (*immutable*). Ato mund të arkivohen, por, në asnjë rast, të fshihen;

gj) Çdo gjurmë (*log*) duhet të ketë një numër identifikues unik;

h) Të paktën një kopje e plotë e përditësuar e të gjithë bazës së të dhënave duhet të ruhet brenda territorit të vendit, ku është licencuar organizatori/subjekti.

1.7 Ndërfaqet *web* dhe aplikacionet *mobile*:

a) Sistemi duhet të ketë një ndërfaqe të disponueshme 24/7, që është e aksesueshme nëpërmjet *web*-it dhe/ose aplikacionit, pavarësisht llojit e tipit të pajisjes që përdoret;

b) Përshtatshmëria e ndërfaqes nuk duhet të jetë e pavarur nga të dhënat e pajisjes, nga e cila ajo po aksesohet, si: sistemi i operimit, rezolucioni, dimensionet e ekranit;

c) Ndërfaqja duhet të lejojë përdoruesit të krijojnë llogari, të kyçen e të menaxhojnë profilin e tyre;

ç) Ndërfaqja dhe/ose aplikacioni duhet të jetë e/i përshtatshme/ëm për t'u aksesuar nga çdo pajisje elektronike;

d) Ndërfaqja dhe/ose aplikacioni duhet të jetë e/i përshtatshme/ëm pavarësisht sistemit operativ të përdorur dhe të ofrojë funksionalitete të njëjta me versionin e faqes së internetit;

dh) Infrastruktura *hardware* duhet të ketë kapacitet të mjaftueshëm për të përballuar ngarkesa të larta të përdoruesve dhe të trafikut, duke garantuar kohë përgjigjeje nën 200 ms për çdo transaksion dhe vazhdimësi të shërbimit (*uptime e*” 99.9%);

e) Performanca duhet të përfshijë përpunimin në kohë reale të basteve, llogaritjeve të kuotave dhe të transaksioneve;



ë) Sistemi duhet të funksionojë në një infrastrukturë *hardware* të sigurt, të certifikuar dhe të besueshme, që përfshin serverat, pajisjet e rrjetit, pajisjet e ruajtjes së të dhënave dhe komponentët e sigurisë fizike, në përputhje me ligjin nr. 155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

f) Në menunë, ku shfaqet bilanci i kreditit apo i debitit të klientit, duhet të shfaqet gjendja reale e llogarisë së klientit në çdo kohë, sipas monedhës së llogarisë (lek, euro, dollar amerikan), për çdo rast kur klienti është i loguar;

g) Çdo konvertim i mundshëm nga një valutë në një tjetër duhet të paraqitet qartësisht për klientët së bashku me rregullat e konvertimit. Kur konvertimi kryhet në kredite, konvertimi duhet të paraqitet qartësisht për klientin;

gj) Ndërfaqja duhet të paraqesë informacion për klientin për përzgjedhjet që ai ka bërë, llojin e lojës/bastit që ka zgjedhur të luajë, koeficientët e pranuar. Format i koeficienteve, që do të merren në konsideratë në lojë, si dhe rregullorja e çdo tipologjie loje duhet të jenë qartësisht të përcaktuara në termat e në kushtet, që do të publikohen në ndërfaqen në *web/mobile* ose aplikacione;

h) Ndërfaqja *web* ose *mobile* duhet të jetë minimalisht në dy gjuhë (shqip dhe anglisht) me mundësi zgjedhjeje nga përdoruesi;

i) Ndërfaqja *web* ose *mobile* duhet të ketë të përfshira raporte për përdoruesin mbi veprimtarinë e tij të lojës;

j) Ndërfaqja duhet të ketë kohë ngarkimi jo më të lartë se 3 (tri) sekonda për rrjete 4G;

k) Ndërfaqja *web* ose *mobile* duhet të ketë të integruar mekanizmat e skadimit të sesionit pas një periudhe pasiviteti të përdoruesit;

l) Ndërfaqja duhet të ketë të integruara protokollat HTTPS me TLS të versionit të fundit stabil të lëshuar, në çdo pikë fundore (*endpoint*);

ll) Ndërfaqja duhet të administrojë të dhënat personale, në përputhje me legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e të dhënave personale dhe GDPR-në;

m) Të gjitha fushat sensitive (llogari, ID, karta) duhet të jenë të maskuara në ndërfaqen e përdoruesit (UI);

n) Ndërfaqja duhet të mundësojë ngarkimin e dokumenteve (ID, pasaportë) në format *.pdf*;

nj) Ndërfaqja duhet të ketë të integruara mekanizma mbrojtës nga sulmet dashakeqe, si: *Anti-*

CSRF tokens, *rate-limiting* për API, *CAPTCHA/reCAPTCHA* për log-in dhe regjistrim;

o) Ndërfaqja duhet të ketë të integruara mekanizmat, që mundësojnë që të gjitha të dhënat sensitive (fjalëkalime, ID, kartat, bilancet, historiku i basteve, të dhënat personale) të ruhen në bazën e të dhënave dhe jo në *browser* apo në pajisjen lokale;

p) Çdo komunikim me bazën e të dhënave dhe sistemin qendror duhet të kryhet në mënyrë të enkriptuar me nivel enkriptimi minimalisht AES256 ose ekuivalent;

q) Ndërfaqja duhet të ketë të publikuara, në një vend të dukshëm për përdoruesin, në një gjuhë të kuptueshme, të gjitha rregullat e lojës, kufizimet e mundshme dhe të gjitha mundësitë e fitimit ose të humbjes së lojtarëve;

r) Të gjitha shumat, që lidhen me lojën dhe fitimet, duhet të kuotohen me simbolin e valutës, me të cilën lojtari është duke luajtur;

rr) Lojërat e hapura me ndërfaqe “*full screen*”, gjatë të gjithë kohës, duhet të mundësojnë shfaqjen e orës reale;

s) Lojërat e hapura me ndërfaqe “*full screen*” duhet të kenë në çdo moment një opsion të dukshëm për të dalë nga loja;

sh) Ndërfaqja duhet të përmbajë në mënyrë të dukshme informacion mbi licencën e organizatorit, emrin e organizatorit, sipas licencës që disponon, adresën e organizatorit, kontaktin e organizatorit dhe një njoftim për përgjegjshmërinë në lojë, i cili duhet të informojë përdoruesit për dëmet që mund të shkaktojë pjesëmarrja e pakontrolluar në lojërat e fatit sipas rregullores së publicitetit të miratuar nga Komisioni i Licencave;

t) Kushtet e përdorimit dhe rregulloret, që lidhen me lojën, duhet të jenë në ndërfaqen kryesore ose në një vendndodhje jo më të fshehur sesa vetëm një klikim nga ndërfaqja kryesore;

th) Ndërfaqja duhet të ofrojë në mënyrë të lehtë për lojtarët një mundësi për të vendosur një kufi mbi shumën që mund të depozitohet dhe/ose luhet dhe/ose mbi humbjet që mund të ndodhin, brenda një periudhe të caktuar kohore, gjatë regjistrimit ose menjëherë pas regjistrimit në hyrjen e parë, dhe kjo mundësi mbetet e disponueshme për lojtarin në çdo kohë pas regjistrimit;

u) Ndërfaqja duhet të ofrojë në mënyrë të lehtë për lojtarët mundësinë për t’u përjashtuar vetë, në mënyrë të përcaktuar ose të pacaktuar dhe këto



kufizime zbatohen për të gjitha lojërat që ofrohen nga i licencuari në të njëjtën faqe interneti;

v) Në rastet kur ndërfaqja u ofron lojtarëve, që janë vetëpërfshirë për një periudhë të përcaktuar, mundësinë për të ulur periudhën e përjashtimit ose për ta revokuar atë, ulja ose revokimi mund të ndodhë vetëm pas kalimit të 24 (njëzet e katër) orëve nga momenti kur i licencuari ka marrë një njoftim të tillë;

x) Ndërfaqja duhet t'u ofrojë lojtarëve, që kanë vendosur vetë kufij ose vetëpërfshirje, mundësinë për t'i reduktuar kufijtë, duke i bërë më të rreptë, dhe/ose për të zgjatur periudhën e përjashtimit. Çdo ndryshim i tillë duhet të hyjë në fuqi menjëherë pasi i licencuari të ketë marrë njoftimin përkatës;

xh) Sistemi nuk duhet të pranojë asnjë bast nga një lojtar në kundërshtim me një kufi ose përjashtim të vendosur nga vetë lojtari;

y) Sistemi përjashton nga listat e postimeve "marketing" lojtarët, që kanë zgjedhur vetëpërfshirjen, për aq kohë sa vetëpërfshirja është në fuqi. Përjashtimi nga lista e postimeve duhet të hyjë në fuqi jo më vonë se 24 (njëzet e katër) orë pas momentit që lojtari zgjedh vetëpërfshirjen;

z) Sistemi duhet të mundësojë, si më poshtë:

i. të jetë në gjendje t'u ofrojë lojtarëve historikun e transaksioneve të lojërave;

ii. të jetë në gjendje t'u ofrojë lojtarëve historikun e transaksioneve financiare, duke përfshirë totalin e depozitave, tërheqjeve, fitimeve/humbjeve dhe pozicionin neto, total;

iii. të ofrojë informacion të detajuar për secilën lojë;

iv. të shfaqë emrin e secilës lojë;

v. të komunikojë kufizimet e lojës;

vi. të ofrojë udhëzime se si luhet;

vii. të ofrojë një tabelë pagesash për të gjitha shpërblimet dhe veçoritë speciale;

viii. të shfaqë bilancin aktual të llogarisë së lojtarit;

ix. të shfaqë në çdo kohë bilancin e llogarisë së lojtarit dhe monedhën përkatëse.

1.8 Infrastruktura mbajtëse:

a) Sistemi duhet të sigurojë funksionim të vazhdueshëm (24/7) dhe rikuperim automatik, në rast dështimi;

b) Komponentët kritikë (serverat, databazat, API) duhet të kenë *redundance* të plotë (N+1);

c) Infrastruktura duhet të përballojë dështime të pjesshme pa ndërprerë shërbimin (nuk duhet të ketë *single point of failure*);

ç) *Datacenter*-i, ku është hostuar sistemi, duhet të jetë i certifikuar minimalisht me standardin ISO/IEC 27001 dhe 22301, dhe të ketë akses të kontrolluar fizikisht, nëpërmjet kartave biometrike, CCTV, dhe regjistrim hyrje-daljesh;

d) Të gjithë komponentët e shërbimit duhet të jenë nën kontroll qendror të administrimit, auditimit e të monitorimit;

dh) Rrjeti duhet të ndahet në zona funksionale:

i. zona e përdoruesve (*front-end*);

ii. zona e aplikacionit (*application zone*);

iii. zona e bazës së të dhënave (*data zone*);

iv. zona e administrimit dhe auditimit;

e) Ndërveprimet ndërmjet zonave duhet të kufizohen me rregulla të rrepta dhe të dokumentuara të kontrollit të trafikut;

ë) Çdo kufi rrjeti duhet të mbrohet me *firewall*, me rregulla "*default deny*" dhe leje vetëm për portat dhe protokollet e nevojshme;

f) Trafiku hyrës ndaj shërbimeve kritike (baste, pagesa, identifikim) duhet të shpërndahet në mënyrë të ekuilibruar;

g) Çdo përdorues, aplikacion ose shërbim duhet të ketë vetëm nivelin minimal të aksesit, që i nevojitet për funksion;

gj) Duhet të ekzistojnë mekanizma për zbutje të sulmeve volumetrike dhe ruajtje të disponueshmërisë së platformës;

h) Sistemi duhet të përditësohet rregullisht për të eliminuar dobësitë e njohura (*patch management*);

i) Sistemi duhet të ketë mekanizma *backup* dhe rikuperimi për të minimizuar ndërprerjet e shërbimit dhe për të siguruar që aktiviteti i basteve sportive të vazhdojë pa ndërprerje, edhe në rast të dështimeve të pajisjeve, rrjetit, energjisë elektrike dhe situatave emergjente të tjera. Këto mjete dhe teknologji duhet të mundësojnë që dhe në rastet e ndërprerjes së aktivitetit si pasojë e ngjarjeve të paparashikuara, që bëjnë të pamundur vijimin e aktivitetit, platforma dhe sistemi të rikthehen në një kohë të shpejtë, në mënyrë të sigurt, në gjendjen që ishin përpara ndodhjes së ngjarjes së papritur me të dhëna të plota, duke u siguruar që ato janë të pandryshuara dhe të plota;

j) Kjo përfshin përdorimin e serverave të *backup*-it, sistemeve të *power supply*, të mjeteve të *load balancing* dhe të teknologjive të tjera për të siguruar që sistemi të jetë i përgatitur për situata të paparashikuara;

k) *Backup*-et duhet të kryhen në mënyrë strikte dhe të ruhen në vende të sigurt, të ndryshme nga



vendndodhja primare, ku është hostuar sistemi, për të siguruar rikthimin e të dhënave në rastet e nevojshme;

l) Vendndodhja fizike e *mirror servera*-ve dhe e infrastrukturës duhet të jetë e sigurt e të mbrohet nga rreziqet fizike. Kjo përfshin aksesimin e kontrolluar fizik në *datacenter* dhe në sisteme të sigurisë fizike për të parandaluar hyrjet e paautorizuara dhe vjedhjen e pajisjeve fizike;

ll) Duhet të zbatohen mekanizma për mbrojtjen e të dhënave, duke përfshirë enkriptimin e të dhënave, sigurimin e kopjeve *backup* të të dhënave dhe përdorimin e politikave dhe të standardeve të sigurisë për të mbrojtur integritetin dhe konfidencialitetin e të dhënave;

m) Sistemet e monitorimit, *firewall*-et, antiviruset dhe *software*-t e mbrojtjes së të dhënave duhet të jenë të implementuara për të mbrojtur sistemin nga rreziqet e sigurisë. Të gjitha këto elemente duhet të jenë në përputhje me standardet dhe direktivat e miratuara nga Bashkimi Evropian;

n) Sistemet e ndërprerjes së energjisë (UPS) dhe planifikimi i rezervave të energjisë duhet të jenë të përfshira për të mbajtur sistemin në funksionim, në raste emergjente;

nj) Subjekti duhet të sigurojë zinxhirin e furnizimit të pajisjeve, për të siguruar që dështimi i një pajisjeje ose mosofrimi i mbështetjes teknike nga prodhuesi të mos ndikojë dhe të mos impaktojë në dështimin e sistemit. Asnjë element i infrastrukturës nuk duhet të funksionojë/operojë, nëse ka status *End of Support* ose *End of Life* nga prodhuesit përkatës;

o) Për të minimizuar vonesat dhe dështimet e lidhjes, duhet të ketë minimalisht dy lidhje interneti të dedikuara nga dy burime të ndryshme me kapacitet të lartë, një primar dhe një *backup*;

p) Në rrjet duhet të jenë implementuar mekanizma, në mënyrë që rrjeti të jetë i mbrojtur nga rreziqet e sigurisë dhe të ketë mekanizma të sigurisë për të parandaluar akseset e paautorizuara dhe sulmet nga të tretët;

q) Sistemet e ndërprerjes së energjisë (UPS) dhe planifikimi i rezervave të energjisë duhet të jenë të përfshira për të siguruar që rrjeti të vazhdojë të funksionojë edhe në raste humbjeje të energjisë;

r) Regjistrat elektronikë duhet të jenë të strukturuar në mënyrë kronologjike dhe të pandryshueshme, duke përmbytur të dhëna të detajuara për çdo ngjarje, si: data, ora, përdoruesi, IP

adresa dhe rezultati i veprimit. Ruhen për jo më pak se 5 (pesë) vjet.

rr) Regjistrat duhet të mbrohen nga modifikimi, fshirja apo manipulimi i paautorizuar, duke përdorur mekanizma kriptografikë të integritetit të të dhënave (*hashing* dhe *timestamping*).

1.9 Rrjeti në sistemet e basteve *online*:

a) Rrjeti duhet të jetë i dedikuar, me kapacitet të lartë (minimumi 1 Gbps) dhe me *redundance* të plotë për të përballuar trafikun intensiv të basteve *online*;

b) Për të garantuar cilësi dhe qëndrueshmëri, rrjeti duhet të ketë dy lidhje të pavarura interneti (dual ISP) dhe sistem *failover* automatik;

c) Rrjeti duhet të ketë kanal rezervë komunikimi (*redundant path*) për të shmangur ndërprerjet e shërbimit;

ç) Të gjithë komponentët e rrjetit duhet të jenë të mbrojtur nga akseset e paautorizuara, DDoS, *spoofing* dhe *intrusion attempts* nëpërmjet *firewall*-eve, VPN-ve dhe IDS/IPS-ve të avancuara;

d) Të gjitha komunikimet e brendshme dhe të jashtme duhet të jenë të enkriptuara me SSL/TLS 1.3 ose protokolle ekuivalente të sigurisë;

dh) Subjekti duhet të dokumentojë teknologjitë e rrjetit, konfigurimet, testimet dhe auditimet periodike, për të verifikuar përputhjen me standardet e kërkesat ligjore.

1.10 Dokumentimi:

a) Platforma duhet të jetë e dokumentuar mirë për të lehtësuar përdorimin, mirëmbajtjen e zhvillimin e mëtejshëm;

b) Manuali i përdoruesit, dokumentacioni teknik dhe udhëzimet e instalimit e të konfigurimit duhet të jenë të disponueshme, të përditësohen rregullisht dhe të verifikohen nga AMLF-ja në terren;

c) Organizatori duhet të mbajë dokumentacion të përditësuar lidhur me elementet kryesore të ekosistemit të platformës së tij, të cilin duhet t'ia vendosë në dispozicion dhe AMLF-ja. Ky dokumentacion duhet të përfshijë minimalisht elementet, si më poshtë vijon:

i. pajisjet *hardware* të përdorura, përfshirë markën, modelin dhe çdo element tjetër, që identifikon pajisjen. Gjithashtu, duhet të specifikohet dhe vendndodhja fizike e pajisjes. Kjo vendndodhje duhet të deklarohet edhe në rast se organizatori përdor infrastrukturë “*on cloud*”;

ii. të gjitha makinat virtuale të përdorura (nëse ka të tilla), përfshirë elemente që identifikojnë makinën virtuale dhe vendndodhjen, ku ato janë të hostuara;



iii. lidhjet ndërmjet nyjave të rrjetit;

iv. aplikacionet e instaluara në *hardware* dhe/ose makinat virtuale duke përfshirë dhe një përshkrim të specifikimeve të tyre teknike;

ç) Organizatori duhet të marrë më parë miratimin paraprak nga AMLF-ja për çdo ndryshim të sistemit dhe të rregulloreve, përpara se ky ndryshim të fillojë të aplikohet nga organizatorë.

III. FATURAT DHE TRANSAKSIONET E PAGESAVE

1. Platforma duhet të ofrojë një gamë të sigurt të opsioneve të pagesës për përdoruesit. Kjo përfshin përdorimin e protokolleve të sigurisë për transmetimin e të dhënave të pagesave dhe përdorimin e metodave të sigurta të pagesave, që lejon legjislacioni bankar.

2. Kërkesat e sigurisë, si protokollat e enkriptimit dhe verifikimi i transaksioneve, duhet të jenë të implementuara për të mbrojtur të dhënat financiare të përdoruesve.

3. Platforma duhet të zbatojë masat e nevojshme për të mbrojtur financat e përdoruesve nga mashtrimi dhe akses i paautorizuar, në përputhje me direktivat dhe legjislacionin shqiptar dhe të Bashkimit Evropian.

4. Platforma duhet të jenë transparente lidhur me politikat e pagesave, tarifat dhe komisionet e aplikueshme për përdoruesit.

5. Platforma, gjithashtu, duhet të jetë e pajtueshme me rregulloret dhe legjislacionin e aplikueshëm lidhur me financat, duke përfshirë identifikimin e përdoruesve, raportimin e transaksioneve dhe zbatimin e masave kundër pastrimit të parave.

6. *Software*-i duhet të jetë i aftë për të mbështetur një gamë të gjerë, të verifikuar dhe të miratuar nga AMLF-ja, të llojeve të bastit, të disponueshme në sporte të ndryshme, në përputhje me ligjin nr.155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Kjo përfshin bastet e thjeshta (p.sh. rezultatit përfundimtar), bastet e kombinuara (kombinimi i disa ngjarjeve të ndryshme në një kupon të vetëm), bastet *live* në kohë reale, si dhe bastet e parashikimeve të veçanta (p.sh. numri i golave, kartonëve etj.), gjithmonë brenda kufijve të përcaktuar nga licenca dhe rregullorja përkatëse.

7. Çdo lloj basti që ofrohet duhet të jetë i dokumentuar dhe i miratuar nga AMLF-ja përpara vënies në dispozicion të lojtarëve.

8. Protokollet e pagesave, që do të mundësojë platforma, duhet të integrohen në SQMO.

9. Çdo biletë basti *online* dhe faturë elektronike duhet të përmbajnë të paktën elementet e mëposhtme ligjore dhe teknike:

a) Numrin unik të identifikimit të biletës dhe të faturës;

b) Datën dhe orën e vendosjes së bastit;

c) Emrin tregtar dhe NIPT-in e operatorit të licencuar;

ç) Identifikuesin unik të lojtarit (ID ose *username*);

d) Përshkrimin e ngjarjes sportive, koeficientin (*odd*) dhe shumën e bastit;

dh) Shumën totale të fitimit potencial;

e) Referencën e sistemit të pagesës (metoda e përdorur – bankë, kartë, portofol elektronik, agjenci pagesash);

ë) Vërtetimin automatik të sistemit (nënshkrim elektronik ose kod sigurie);

f) Numrin e licencës së operatorit dhe logon e institucionit mbikëqyrës;

g) Njoftimin ligjor për përgjegjësinë e lojtarit dhe ndalimin për të miturit, sipas programit të mbrojtjes së lojtarit dhe të rregullores së publicitetit (“Lojërat e fatit krijojnë varësi. Kujdes në ushtrimin e tyre të tejzgjatur!”).

IV. PARIMET E SIGURISË DHE KUSHTET E KONTROLLIT

1. Integriteti dhe transparenca e të dhënave

1.1 Të gjitha veprimet e sistemit (bastet, fitoret, humbjet, anulimet, gabimet, depozitimet dhe tërheqjet) duhet të regjistrohen në kohë reale dhe në format të pandryshueshëm, të cilat mund të rikrijohen nga regjistrat teknike (*logs*).

1.2 Çdo ndryshim në të dhëna duhet të ruajë historikun origjinal dhe të jetë i gjurmueshëm për auditim e verifikim.

2. Masat teknike të sigurisë

2.1 Përdorimi i certifikatave SSL për mbrojtjen e të dhënave në transmetim;

2.2 Zbatimi i standardeve ndërkombëtare: ISO 9001, ISO/IEC 27001, ISO/IEC 27017 dhe ISO/IEC 27018 për menaxhimin e sigurisë dhe mbrojtjen e të dhënave personale;

2.3 Enkriptimi i të dhënave, autentifikimi shumëfaktorësh, autorizimi dhe kontrollet e qasjes për të garantuar, që vetëm personat e autorizuar kanë akses.

3. Mbrojtja fizike dhe logjike e infrastrukturës



3.1 Serverat, rrjetet dhe pajisjet duhet të jenë të mbrojtura fizikisht dhe logjikisht dhe të survejuara për 24 (njëzet e katër) orë;

3.2 Të sigurohet *backup* ditor dhe plan rikuperimi nga fatkeqësitë (*disaster recovery plan*);

3.3 Të dhënat personale dhe financiare ruhen sipas praktikave më të mira të industrisë dhe standardeve ISO/IEC.

4. Monitorimi dhe auditimi i sigurisë

4.1 Sistemet duhet të monitorohen vazhdimisht për incidente dhe anomalitë e sigurisë;

4.2 Auditime të pavarura të sigurisë kryhen periodikisht dhe raportohen pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit;

4.3 Subjekti i licencuar duhet të hartojë, të zbatojë dhe të mirëmbajë një plan të sigurisë së informacionit (PSI), i cili përmban:

- i. analizën e risqeve;
- ii. politikat e sigurisë;
- iii. masat parandaluese dhe korrigjuese;
- iv. procedurat e reagimit ndaj incidenteve.

4.4 Ky plan duhet të përditësohet të paktën një herë në vit dhe të dërgohet për miratim pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit (AMLF).

5. Politikat dhe menaxhimi i incidenteve

5.1 Subjektet zbatojnë politikë të integruar të sigurisë së informacionit, duke përfshirë menaxhimin e rrezikut, planin e reagimit ndaj incidenteve dhe planin e rikuperimit pas fatkeqësive;

5.2 Çdo incident që prek sistemin raportohet menjëherë tek Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit.

6. Dokumentimi teknik e procedural

6.1 Subjekti dokumenton të gjitha masat e zbatimit të sigurisë dhe të auditimeve teknike, përfshirë regjistrat e *log*-eve, planet e rikuperimit dhe raportet e auditimit;

6.2 Dokumentacioni mbahet i azhurnuar dhe është i gatshëm për shqyrtim nga autoritetet mbikëqyrëse.

V. CERTIFIKIMI I SISTEMIT

1. Organizatori i lojës ose subjekti që zhvillon e mirëmban platformën e basteve *online* duhet të disponojë certifikimet e mëposhtme, për sa kohë që ato lëshohen nga autoritete të akredituara, sipas legjislacionit shqiptar dhe/ose evropian:

i. ISO/IEC 27001:2022 – Menaxhimi i Sigurisë së Informacionit;

ii. ISO/IEC 22301 – Menaxhimi i Vazhdimësisë së Biznesit;

iii. ISO/IEC 20000 – Menaxhimi i Shërbimeve IT;

iv. PCI DSS – Siguria e të Dhënave të Kartave të Pagesës;

v. ISO 9001 Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë;

vi. GLI-19 (*Gaming Laboratories International*) standard teknik për sistemet e lojërave të fatit *online*;

vii. GLI – 33 (*Gaming Laboratories International*) standard teknik për sistemet e lojërave të fatit *online*.

2. Certifikimet duhet të jenë të vlefshme dhe aktive gjatë gjithë kohës së ushtrimit të veprimtarisë dhe operatori është i detyruar të depozitojë pranë AMLF-së kopjet e certifikatave për verifikim dhe auditim.

3. Certifikimi përfshin verifikimin e funksionalitetit, të sigurisë, të integritetit të të dhënave, auditueshmërisë dhe të disponueshmërisë së sistemit.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohen Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, Komisioni i Licencave dhe subjektet e licencuara të lojërave të fatit në kategorinë “Baste sportive *online*” për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 152, datë 11.3.2026

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 566, DATË 29.7.2022,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE TË
PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES SË
ORGANIZATAVE RINORE DHE
ORGANIZATAVE PËR TË RINJTË,
QË PËRFITOJNË FINANCIME NGA
FONDET GRANT NGA BUXHETI I
SHTETIT, TË DEDIKUARA
PËR RININË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 15, të ligjit nr. 75/2019, “Për rininë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 566, datë 29.7.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave të përzgjedhjes së organizatave rinore dhe organizatave për të rinjtë, që përfitojnë financime nga fondet grant nga buxheti i shtetit, të dedikuara për rininë”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në titull, pas fjalëve “... organizatave për të rinjtë ...” shtohen “... bashkive dhe grupeve joformale rinore ...”.

2. Kudo në tekst, fjalët “... dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore ...” zëvendësohen me “... bashkitë dhe grupet joformale rinore ...”.

3. Në shkronjën “d”, të nenit 2, fjalët “... sipas këtij vendimi ...” zëvendësohen me “... sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për përbërjen, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të komisionit të vlerësimit ...”.

4. Në nenin 6 bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Titulli i nenit zëvendësohet me fjalën “Bashkia”;

b) Fjalët “Njësia e vetëqeverisjes vendore, sipas pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 75/2019, “Për rininë”,...” zëvendësohen me “Bashkia ...”.

5. Pas nenit 6 shtohet neni 6/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 6/1

Grupi joformal rinor

1. Grupi joformal rinor është një formë organizimi e përkohshme dhe vullnetare e të rinjve, e krijuar për konceptimin dhe zbatimin e një iniciative konkrete, me interes komunitar në fushën e zhvillimit rinor, përfshirjes ose mirëqenies së të rinjve.

2. Grupi joformal rinor mund të kërkojë të përfitojë mbështetje financiare nga fondet grant të buxhetit të shtetit, në përputhje me nenin 13/1, të ligjit nr. 75/2019, “Për rininë”, të ndryshuar, kur plotëson kriteret e mëposhtme:

a) Grupi përbëhet nga të paktën 4 (katër) anëtarë të moshës 15–29 vjeç, të cilët angazhohen në mënyrë vullnetare për realizimin e një iniciative të bazuar në nevojat e komunitetit;

b) Grupi vepron mbi baza joformale dhe nuk ka personalitet juridik, por organizohet rreth një qëllimi të përbashkët dhe një plani veprimi të qartë;

c) Grupi cakton një përfaqësues në moshë madhore, me zotësi të plotë për të vepruar, i cili përfaqëson grupin në marrëdhëniet me Agjencinë Kombëtare të Rinisë dhe palët e treta, si dhe mban përgjegjësi administrative dhe financiare për përdorimin e fondeve;

ç) Grupi paraqet një deklaratë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët, ku përcaktohen përbërja e grupit, qëllimi i iniciativës, rolet e brendshme dhe angazhimi për zbatimin dhe raportimin e projektit;

d) Fondet e përfituara administrohen në përputhje me kushtet e kontratës së grantit dhe legjislacionin në fuqi për menaxhimin e fondeve publike;

dh) Grupi dhe përfaqësuesi i tij angazhohen për raportim përshtues e financiar, si dhe i nënshtrohen kontrollit dhe verifikimit nga Agjencia Kombëtare e Rinisë dhe organet kompetente;

e) Iniciativa është jofitimprurëse, me interes publik/komunitar;

ë) Grupi angazhohet për respektimin e parimeve të mosdiskriminimit, barazisë gjinore, përfshirjes sociale dhe vlerave demokratike.”.

6. Nenet 8 dhe 9 shfuqizohen.

7. Në nenin 11 bëhen shtesat dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Në fund të pikës 1, shtohet fjalia “Aplikimi për mbështetje me grant kryhet elektronikisht nëpërmjet portalit “e-Albania”.”;

b) Në pikën 2, fjalët “... dorëzon dokumentacionin ...” zëvendësohen me “... ngarkon dokumentacionin në portalin qeveritar “e-Albania” ...”;

c) Në fund të shkronjës “a”, të pikës 2, shtohen fjalët “... dhe ekstraktin historik të lëshuar nga gjykata.”;

ç) Pas pikës 2 shtohen pikat 2/1 dhe 2/2, me këtë përmbajtje:

“2/1. Bashkia, që merr pjesë në thirrjen e shpallur për konkurrim, plotëson dokumentet e aplikimit të thirrjes dhe ngarkon dokumentacionin përkatës në portalin qeveritar “e-Albania”, i cili provon plotësimin e kritereve, të përcaktuara në nenin 6, të kreut II, të këtij vendimi, si dhe dokumentet e mëposhtme:



a) Planin arkitekturor për ndërtimin ose rikonstruksionin e objektit publik të infrasktrukturës rinore;

b) Preventivin e punimeve për ndërtimin ose rikonstruksionin e objektit publik të infrastrukturës rinore;

c) Dokumentin që vërteton pronësinë mbi objektin publik të infrastrukturës rinore.

2/2. Grupi joformal rinor, që merr pjesë në thirrjen e shpallur për konkurrim përmes personit të autorizuar, plotëson dokumentet e aplikimit të thirrjes dhe ngarkon dokumentacionin përkatës në portalin qeveritar “e-Albania”, që provon plotësimin e kriterëve të përcaktuara, sipas rastit, në nenin 6/1, të kreut II, të këtij vendimi.”

8. Pas pikës 3, të nenit 15, shtohet pika 4, me këtë përmbajtje:

“4. Lista e projektpropozimeve fituese të grupeve joformale rinore miratohet nga ministri përgjegjës për rininë, brenda 5 (pesë) ditëve kalendrike nga përfundimi i procesit të vlerësimit. Nëse ministri ka vërejtje për procesverbalin e vlerësimit dhe dokumentacionin shoqërues, e rikthen praktikën pranë komisionit, të shoqëruar me vërejtjet përkatëse. Komisioni mbledhet dhe reflekton vërejtjet në procesverbalin e vlerësimit, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendrike nga përfundimi i procesit të vlerësimit.”

9. Në pikën 1, të nenit 16, dhe kudo në përmbajtjen e projektvendimit, fjalët “... e miratimit të procesverbalit të vlerësimit të projektpropozimeve ...” zëvendësohen me “... e miratimit të listës së projektpropozimeve fituese ...”.

10. Në nenin 17 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Në pikën 1, pas fjalëve “... njofton kandidatin ...” shtohen “... nëpërmjet portalit qeveritar “e-Albania” ...”;

b) Në fjalinë e parë, të pikës 2, fjalët “... miratimin e tij ...” zëvendësohen me “... miratimin, nëpërmjet portalit qeveritar “e-Albania” ...”;

c) Në pikën 3, pas fjalës “... njofton ...” shtohen fjalët “... nëpërmjet portalit qeveritar “e-Albania” ...”;

ç) Në pikën 4, fjalët “... pranë ministrit përgjegjës për rininë ...” zëvendësohen me “... sipas rastit, pranë ministrit përgjegjës për rininë apo titullarit të AKR-së ...”.

11. Neni 18 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 18

E drejta e ankimit

Organizata rinore, organizata për të rinjtë, bashkia dhe grupi joformal rinor, të përzgjedhura jofituese në procedurën e konkurrencës, kanë të drejtë të paraqesë ankim administrativ pranë ministrit përgjegjës për rininë në portalin qeveritar “e-Albania”. Ankimi paraqitet brenda 10 (dhjetë) ditëve nga njoftimi për mosshpalljen fitues. Ankimi shqyrtohet brenda 10 (dhjetë) ditëve nga komisioni *ad hoc* për shqyrtimin e ankimit. Përbërja emërore e komisionit përcaktohet me urdhër të ministrit. Rregullat, procedurat dhe afatet kohore të ankimit administrativ bazohen në dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative. Në rast të pasaktësive ose mangësive formale në kërkesën për ankim, autoriteti kompetent i jep palës një afat të arsyeshëm për plotësimin e tyre, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.”

12. Pas pikës 2, të nenit 20, shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:

“3. Grupit joformal rinor i lëvrohet fondi për projektin në 3 (tri) këste:

a) Kësti i parë, 50 (pesëdhjetë) % e vlerës së fondit, menjëherë pas nënshkrimit të kontratës së grantit;

b) Kësti i dytë, 40 (dyzet) % e vlerës së fondit, menjëherë pas miratimit nga AKR-ja të raportit përshkrues e financiar të fazës së parë;

c) Kësti i tretë, 10 (dhjetë) % e vlerës së fondit, pas miratimit nga AKR-ja të raportit përshkrues dhe financiar përfundimtar.”

13. Kreu V emërtohet “DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMITARE”.

14. Pas nenit 23 shtohet neni 23/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 23/1

Administrimi i projektpropozimeve

Deri në ngritjen dhe funksionimin e sistemit elektronik për financimin e projekteve të dedikuara dhe regjistrin elektronik për të rinjtë, aplikimet e kandidatëve për përfitim të financimeve, nëpërmjet fondit grant të dedikuar për rininë, si dhe për ankime administrative do të administrohen në format fizik, nëpërmjet rrugëve postare dhe nëpërmjet postës elektronike, pranë AKR-së.”



II. Ngarkohen ministria përgjegjëse për rininë dhe Agjencia Kombëtare e Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

URDHËR I PËRBASHKËT

Nr. 81, datë 30.1.2026

PËR NGRITJEN DHE PËRBËRJEN E KOMITETIT SEKTORIAL TË BUJQËSISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës; të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr. 10 247, datë 4.3.2010, “Për kornizën shqiptare të kualifikimeve”, të ndryshuar; të vendimit nr. 426, datë 26.6.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e organizimit, të funksionimit, si dhe kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve të komiteve sektoriale dhe mënyrën e shpërblimit të tyre”, ministri përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional dhe ministri përgjegjës për arsimin,

URDHËROJNË:

1. Ngritjen e Komitetit Sektorial të Bujqësisë.
2. Komiteti Sektorial i Bujqësisë organizohet në formën e grupit teknik dhe ka në përbërje 10 (dhjetë) anëtarë si më poshtë:
 - a) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për arsimin;
 - b) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional;
 - c) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për sektorin e Bujqësisë;
 - ç) një përfaqësues nga shoqatat e punëdhënësve të sektorit të Bujqësisë, me numrin më të madh të anëtarëve në sektorin përkatës;
 - d) një përfaqësues nga shoqatat e punëmarrësve që mbulojnë sektorin e Bujqësisë, me numrin më të madh të anëtarëve në sektorin përkatës;
 - dh) një përfaqësues nga institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional (AFP) të sektorit të Bujqësisë, me numrin më të madh të nxënësve/kursantëve në sektorin përkatës;
 - e) një përfaqësues të biznesit me praktika të pasura në zhvillimin e burimeve njerëzore në sektorin e Bujqësisë;

ë) tre ekspertë të pavarur, me përvojë jo më pak se 5 (pesë) vjet në zhvillimin dhe zbatimin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK).

3. Kryetari zgjidhet në mbledhjen e parë të komitetit dhe, si rregull, duhet të jetë anëtar me më shumë eksperiencë në çështjet e Bujqësisë dhe në zhvillimin e zbatimit të KSHK-së.

4. Ngarkohet Ministria Ekonomisë, dhe Inovacionit për përzgjedhjen e përfaqësuesve respektivë, sipas germave “a”, “b”, “c”, dhe “d”, të pikës 2 të këtij urdhri, në bazë të kriterëve të parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 426, datë 26.6.2019, dhe përcjelljen e tyre Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK), jo më vonë se 3 (tre) muaj nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.

5. Ngarkohet AKAFPK-ja për përzgjedhjen e anëtarëve, sipas shkronjave “ç”, “d”, “e” dhe “ë”, të pikës 2 të këtij urdhri, si dhe titullari i saj për ngritjen e sekretariatit teknik, brenda 3 (tre) muajve nga hyrja e tij në fuqi.

6. Ngarkohen ministria përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional, ministria përgjegjëse për arsimin, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve dhe Komiteti Sektorial i Bujqësisë, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I EKONOMISË
DHE INOVACIONIT
Delina Ibrahimaj

MINISTËR I ARSIMIT
Mirela Kumbaro

URDHËR Nr. 156, datë 4.3.2026

PËR DISA NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 99, DATË 25.5.2021, “PËR MIRATIMIN E KATALOGUT KOMBËTAR TË KUALIFIKIMEVE PROFESIONALE”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 17, të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”,



URDHËROJ:

1. Miratimin e ndryshimeve në Katalogun Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale, sipas shtojcës 1.1 bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Botimin e ndryshimeve dhe të Katalogut Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve.

3. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I EKONOMISË DHE
INOACIONIT
Delina Ibrahimaj

SHTOJCA 1.1
NDRYSHIMET NE KATALOGUN KOMBËTAR TE KUALIFIKIMEVE
PROFESIONALE – 2026

Nr.	Varianti i mëparshëm i kualifikimit profesional	Kodi i kualifikimit profesional dhe i njësive të të nxënës	Emërtimi i kualifikimeve	Emërtimi i njësive të të nxënës	Lloji i kualifikimit profesional	Profesionet LKP	Lidhja me kodet e LKP/ISCO	Kualifikim i plotë/ i pjesshëm	Niveli në KSHK
1		K-L/3-IV-25	Tregti elektronike (e-Commerce)		Program 4-vjeçar për nivelin teknik/menaxher i mesëm	Menaxher i mesëm në tregtinë elektronike (e-commerce)	5244.05	I plotë	4
1-a		NjN-11-IV-0432-25		Planifikimi dhe organizimi i punës për tregtinë elektronike (e-Commerce)	Kualifikim i të nxënës gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
1-b		NjN-11-IV-0356-25		Bazat e ekonomiksit	Kualifikim i të nxënës gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
1-c		NjN-11-IV-0433-25		Bazat e së drejtës në biznes për tregtinë elektronike	Kualifikim i të nxënës gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
1-d		NjN-11-IV-0434-25		Bazat e tregtisë	Kualifikim i të nxënës gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
1-e		NjN-11-IV-0435-25		Menaxhimi i produkteve në platformën online	Kualifikim i të nxënës gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
1-f		NjN-11-IV-0436-25		Veprime në magazinë	Kualifikim i të nxënës gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
1-g		NjN-11-IV-0437-25		Bazat e marketingut	Kualifikim i të nxënës gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
1-h		NjN-11-IV-0438-25		Marketing digital	Kualifikim i të nxënës gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
1-i		NjN-11-IV-0439-25		Bazat e logistikës	Kualifikim i të nxënës gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
1-j		NjN-11-IV-0440-25		Menaxhimi i të dhënave në tregtinë elektronike	Kualifikim i të nxënës gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
1-k		NjN-11-IV-0441-25		Menaxhimi i platformës e-Commerce/wheshop	Kualifikim i të nxënës gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
1-l		NjN-11-IV-0442-25		Optimizimi i motorëve të kërkimit	Kualifikim i të nxënës gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
1-m		NjN-11-IV-0443-25		Shërbimi ndaj klientit	Kualifikim i të nxënës gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
1-n		NjN-11-IV-0444-25		Llogaritje dhe kontabilizime të thjeshta	Kualifikim i të nxënës gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
1-o		NjN-11-IV-0445-25		Shitjet, pagesat dhe dokumentacioni financiar	Kualifikim i të nxënës gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
1-p		NjN-22-IV-0006-24		Komunikimi dhe etika profesionale	Kualifikim i të nxënës gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
1-q		NjN-23-IV-0005-24		Sipërmarrje dhe edukim karriere	Kualifikim i të nxënës gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
1-r		NjN-11-IV-0446-25		Rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit në tregti elektronike	Kualifikim i të nxënës gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
2	N-IV-21	K-N-IV-25	Veterinari		Program 4-vjeçar për nivelin teknik/menaxher i mesëm	Teknik/menaxher i mesëm në veterinar	3240	I plotë	4
2-a		NjN-13-IV-0447-25		Planifikimi dhe organizimi i punës në veterinar	Kualifikim i të nxënës gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
2-b		NjN-13-IV-0448-25		Bazat e anatomisë, fiziologjisë dhe patologjive në kafshë	Kualifikim i të nxënës gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
2-c		NjN-13-IV-0449-25		Higjiena, shëndeti i kafshëve dhe mirëqenia e tyre	Kualifikim i të nxënës gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
2-d		NjN-13-IV-0450-25		Mikroorganizmat, infeksioni, sëmundjet infektive dhe profilaksia e tyre	Kualifikim i të nxënës gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
2-e		NjN-13-IV-0451-25		Sëmundjet e brendshme dhe diagnoza e tyre	Kualifikim i të nxënës gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
2-f		NjN-13-IV-0452-25		Kujdesi për shëndetin riprodhues të kafshëve	Kualifikim i të nxënës gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
2-g		NjN-13-IV-0453-25		Kujdesi për të ushqyerit e kafshëve	Kualifikim i të nxënës gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
2-h		NjN-13-IV-0454-25		Kirurgjia profilaktike me procedura kirurgjikale	Kualifikim i të nxënës gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
2-i		NjN-13-IV-0455-25		Administrimi i preparateve mjekësore veterinar	Kualifikim i të nxënës gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
2-j		NjN-13-IV-0456-25		Kampionimi për analiza laboratorike dhe kërkim shkencor	Kualifikim i të nxënës gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4



2-k		NjN-13-IV-0457-25		Kontrolli i produkteve me origjinë shtazore	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
2-l		NjN-23-IV-0005-24		Sipërmarje dhe edukim karriere	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
2-m		NjN-22-IV-0006-24		Komunikimi dhe etika profesionale	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
2-n		NjN-13-IV-0458-25		Rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit në veterinar	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
3	O-IV-21	K-O-IV-25	Shërbime sociale dhe shëndetësore		Programi 1 vit studimi për teknik/menaxher mesëm	Menaxher i mesëm në ofrimin e shërbimeve social-shëndetësore	3112	I plotë	4
3-a		NjN-14-IV-0374-25		planifikimi dhe organizimi i punës në shërbimet sociale dhe shëndetësore	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
3-b		NjN-14-IV-0375-25		Identifikimi dhe vlerësimi i nevojave	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
3-c		NjN-14-IV-0376-25		Koordinimi i shërbimeve	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
3-d		NjN-14-IV-0377-25		Monitorimi i shërbimeve	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
3-e		NjN-14-IV-0378-25		Garantimi i cilësisë së shërbimeve	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
3-f		NjN-23-IV-0005-24		Sipërmarje dhe edukim karriere	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
3-g		NjN-22-IV-0006-24		Komunikimi dhe etika profesionale	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
3-h		NjN-14-IV-0379-25		Mbikëqyrja e rregullave të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit në shërbimet sociale dhe shëndetësore	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
4		K-OI-V-25	Shërbime punësimi		Program, pas të mesme 1-vjeçar studimi	Specialist i shërbimeve të punësimit	3333.04	I plotë	5
4-a		NjN-14-V-0380-25		Legjislati në fushën e shërbimeve të punësimit	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	5
4-b		NjN-14-V-0381-25		Planifikimi dhe organizimi i punës në shërbime punësimi	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	5
4-c		NjN-14-V-0382-25		Regjistrimi dhe pasqyrimi i të dhënave në sistemin e shërbimit të punësimit	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	5
4-d		NjN-14-V-0383-25		Promovimi i shërbimeve të punësimit	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	5
4-e		NjN-14-V-0384-25		Mbledhja e të dhënave nga tregu i punës	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	5
4-f		NjN-22-V-0130-24		Komunikimi dhe etika profesionale	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	5
4-g		NjN-14-V-0385-25		Ndërmjetësimi	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	5
4-h		NjN-14-V-0386-25		Këshillimi dhe orientimi	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	5
4-i		NjN-14-V-0387-25		Detra administrative	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	5
4-j		NjN-23-V-0111-24		Sipërmarje dhe edukim karriere	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	5
4-k		NjN-14-V-0388-25		Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	5
5		K-T/1-IV-25	Multimedia		Program 4-vjeçar për nivelin teknik/menaxher i mesëm	Teknik në multimedia	3512	I plotë	4
5-a		NjN-19-IV-0393-25		Planifikimi dhe organizimi i punës në multimedia	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
5-b		NjN-19-IV-0394-25		Pajisjet kompjuterike dhe komponentët	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
5-c		NjN-19-IV-0395-25		Bazat e rrjetit të komunikimit	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
5-d		NjN-19-IV-0396-25		Bazat e programimit në web dhe sistemet e menaxhimit të përmbajtjes	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
5-e		NjN-19-IV-0397-25		Sistemet e operimit dhe programet aplikative	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
5-f		NjN-19-IV-0398-25		Konceptimi i projektit në multimedia	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
5-g		NjN-19-IV-0399-25		Dizajni grafik	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
5-h		NjN-19-IV-0400-25		Realizimi i animacioneve	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
5-i		NjN-19-IV-0401-25		Realizimi i fotove	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
5-j		NjN-19-IV-0402-25		Realizimi i videove	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
5-k		NjN-19-IV-0403-25		Realizimi i audiove	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
5-l		NjN-19-IV-0404-25		Media digjitale, tradicionale dhe përmbajtja	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
5-m		NjN-19-IV-0405-25		Produkti multimedial për prodhim dhe publikim	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
5-n		NjN-19-IV-0406-25		Përdorimi i IA për proceset e punës në multimedia	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
5-o		NjN-19-IV-0407-25		Politikat e sigurisë dhe të drejtat e autorit	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
5-p		NjN-23-IV-0005-24		Sipërmarje dhe edukim karriere	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
5-q		NjN-22-IV-0006-24		Komunikimi dhe etika profesionale	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
5-r		NjN-19-IV-0408-25		Sigurimi teknik dhe mbrojtja e mjedisit në multimedia	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
6		K-T/2-IV-25	Zhvillim website		Program 4-vjeçar për nivelin teknik/menaxher i mesëm	Zhvillues website (i mesëm)	3514	I plotë	4
6-a		NjN-19-IV-0422-25		Planifikimi dhe organizimi i punës për zhvillim website	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4



6-b		NjN-19-IV-0423-25		Bazat e TIK për zhvillim <i>webite</i>	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
6-c		NjN-19-IV-0414-25		Bazat e rrjeteve të komunikimit	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
6-d		NjN-19-IV-0424-25		Sistemet e shfrytëzimit dhe sistemet e menaxhimit të përmbajtjes (CMS)	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
6-e		NjN-19-IV-0425-25		Bazat e programimit dhe algoritmikë	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
6-f		NjN-19-IV-0426-25		Analizimi i kërkesave të klientit	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
6-g		NjN-19-IV-0427-25		Ndërtimi i prototipit	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
6-h		NjN-19-IV-0428-25		Programimi në <i>front end</i>	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
6-i		NjN-19-IV-0429-25		Programimi në <i>back end</i>	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
6-j		NjN-19-IV-0430-25		Testimi i programit / <i>website-it</i>	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
6-k		NjN-19-IV-0431-25		Përdorimi i Inteligjencës Artificiale	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
6-l		NjN-19-IV-0418-25		Siguria kibernetike	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
6-m		NjN-23-IV-0005-24		Sipërmarrje dhe edukim karriere	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
6-n		NjN-22-IV-0006-24		Komunikimi dhe etika profesionale	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
6-o		NjN-19-IV-0421-25		Rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtja e mjedisit	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
7		K-T/3-IV-25	Programim		Program 4-vjeçar për nivelin teknik/menaxher i mesëm	Programues (i mesëm)	2514.03	I plotë	4
7-a		NjN-19-IV-0409-25		Planifikimi dhe organizimi i punës në programim	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
7-b		NjN-19-IV-0410-25		Analiza e zhvillimit të <i>software-ve</i>	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
7-c		NjN-19-IV-0411-25		Bazat e TIK-ut	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
7-d		NjN-19-IV-0412-25		Bazat e programimit	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
7-e		NjN-19-IV-0413-25		Algoritmika dhe struktura e të dhënave	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
7-f		NjN-19-IV-0414-25		Bazat e rrjeteve të komunikimit	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
7-g		NjN-19-IV-0415-25		Zhvillimi i <i>Front end</i>	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
7-h		NjN-19-IV-0416-25		Zhvillimi i <i>back end</i>	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
7-i		NjN-19-IV-0417-25		Menaxhimi i hapësirave hostuese	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
7-j		NjN-19-IV-0418-25		Siguria kibernetike	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
7-k		NjN-19-IV-0419-25		Testimi i aplikacioneve/sistemeve	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
7-l		NjN-19-IV-0420-25		Zhvillimi i sistemeve të thjeshtë IA	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
7-m		NjN-23-IV-0005-24		Sipërmarrje dhe edukim karriere	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
7-n		NjN-22-IV-0006-24		Komunikimi dhe etika profesionale	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
7-o		NjN-19-IV-0421-25		Rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
8		K-X-IV-25	Kërkim, shpim dhe shfrytëzim për naftë, gaz dhe ujë		Programe 1 vit studimi për teknik/menaxher mesëm	Teknik të shpim-shfrytëzimit të vendburimeve të naftës, gazit dhe ujit	3135	I plotë	4
8-a		NjN-21-IV-0389-25		Planifikimi, organizimi dhe koordinimi i punës në kërkim, shpim dhe shfrytëzim për naftë, gaz dhe ujë	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
8-b		NjN-21-IV-0390-25		Mbikëqyrja e proceseve teknologjike (shpimit dhe shfrytëzimit të puseve të naftës, gazit dhe ujit)	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
8-c		NjN-21-IV-0391-25		Mbikëqyrja e cilësisë së punimeve	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
8-d		NjN-23-IV-0005-24		Sipërmarrje dhe edukim karriere	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
8-e		NjN-22-IV-0006-24		Komunikimi dhe etika profesionale	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4
8-f		NjN-21-IV-0392-25		Mbikëqyrja e rregullave të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit në kërkim, shpim dhe shfrytëzim të puseve të naftës , gazit dhe ujit	Kualifikim i të nxënit gjatë gjithë jetës			I pjesshëm	4

**URDHËR****Nr. 192, datë 10.3.2026****PËR DELEGIM KOMPETENCASH**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 9000/2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 512, datë 25.9.2025, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit te zëvendësministri, znj. Lira Pipa, nga data 11.3.2026 deri në datën 13.3.2026, për trajtimin dhe nënshkrimin e akteve administrative dhe shkresave zyrtare që lidhen me çështjet e fushës së kulturës, trashëgimisë dhe rinisë.

2. Zëvendësministri ndalohet të nëndelegojë tek një organ i tretë kompetencat e përfituara përmes këtij akti delegimi.

3. Ngarkohet zëvendësministri i Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit, znj. Lira Pipa, për zbatimin e këtij urdhri.

4. Ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore për komunikimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS
DHE SPORTIT
Blendi Gonxhja

URDHËR**Nr. 193, datë 10.3.2026****PËR DELEGIM KOMPETENCASH**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 9000/2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të neneve 28, 29, të ligjit nr.

44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 512, datë 25.9.2025, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit te zëvendësministri, znj. Marinela Prifti, nga data 11.3.2026 deri në datën 13.3.2026, për trajtimin dhe nënshkrimin e akteve administrative dhe shkresave zyrtare që lidhen me çështjet e fushës së turizmit.

2. Zëvendësministri ndalohet të nëndelegojë tek një organ i tretë kompetencat e përfituara përmes këtij akti delegimi.

3. Ngarkohet zëvendësministri i Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit, znj. Marinela Prifti, për zbatimin e këtij urdhri.

4. Ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore për komunikimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS
DHE SPORTIT
Blendi Gonxhja

URDHËR**Nr. 194, datë 10.3.2026****PËR DELEGIM KOMPETENCASH**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 9000/2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 512, datë 25.9.2025, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit”,



URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit të zëvendësministrit, z. Endrit Hoxha, nga data 11.3.2026 deri në datën 13.3.2026, për trajtimin dhe nënshkrimin e akteve administrative dhe shkresave zyrtare që lidhen me çështjet e fushës së sportit.

2. Zëvendësministri ndalohet të nëndelegojë tek një organ i tretë kompetencat e përfituara përmes këtij akti delegimi.

3. Ngarkohet zëvendësministri i Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit, z. Endrit Hoxha, për zbatimin e këtij urdhri.

4. Ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore për komunikimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS
DHE SPORTIT
Blendi Gonxhja

VENDIM
Nr. 14, datë 17.2.2026

**NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	kryetare;
Sonila Bejtja,	anëtare;
Sandër Beci,	anëtar;
Illir Toska,	anëtar;
Genti Ibrahim,	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare;
Asim Vokshi,	anëtar;
Marsida Xhaferllari,	anëtare,

me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 17.2.2026, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 11 (SH) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: SHOQËRIA “International Distribution for Albania” sh.a., përfaqësuar nga administratori Alban Xhillari.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përfaqësuar nga drejtori i përgjithshëm Ilir Binaj.

Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, përfaqësuar nga drejtore Erilinda Lala.

Avokatura e Shtetit, përfaqësuar nga avokatja e shtetit Irma Qosja.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-13, datë 14.1.2025, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Dërgimi i çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 11, 15, 17, 18, 41, 42, 43, 131, shkronja “P”, 133, 134, pika 1, shkronja “I”, 141, pika 1, dhe 142, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6, 13, 14, 1, të Protokollit nr. 1 dhe Protokollit nr. 12 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*), nenet 27, 50 e vijues, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuësës, shoqërisë “International Distribution for Albania” sh.a. (*kërkuësja*), që ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (*DPT*), Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë (*DRT*) dhe Avokaturës së Shtetit, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuësja ushtron aktivitetin tregtar “Bar-kafe” në Tiranë. Në datën 31.7.2011, organet tatimore kanë ushtruar kontroll në ambientet e kërkuësës dhe kanë konstatuar se shërbimi ofrohej për 100 tavolina dhe për to nuk ishin prerë kuponët tatimor. Për këtë shkelje, bazuar në nenin 122, shkronja “b”, nënparagrafi “i”, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji për Procedurat Tatimore*), kërkuësja është gjobitur me 30 000 000 lekë, që është llogaritur 300 000 lekë për çdo tavolinë.

2. Kërkuësja e ka kundërshtuar masën e gjobës në rrugë administrative dhe gjyqësore. Fillimisht,



Drejtoria e Apelimit Tatimor e ka lënë në fuqi gjobën, ndërsa Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 9195, datë 8.10.2012, ka vendosur ndryshimin e masës së gjobës, duke e ulur në vlerën 300 000 lekë. Mbi apelin e subjektit të interesuar, DRT-së, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 2062, datë 26.5.2014, ka vendosur prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

3. Në rigjykim, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 318, datë 2.2.2015, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë, duke e ulur vlerën e gjobës në 300 000 mijë lekë, me arsyetimin se organi tatimor kishte zbatuar gabim nenin 122, shkronja “b”, nënparagrafi “ii”, të Ligjit për Procedurat Tatimore. Sipas asaj gjykate, bëhej fjalë vetëm për një shkellje të konstatuar, ndaj gjoba nuk mund të caktohej më shumë se 300 000 lekë.

4. Mbi bazën e apeleve të paraqitura nga subjektet e interesuara, DRT-ja dhe Avokatura e Shtetit, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 3014, datë 28.6.2017, ka vendosur ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e padisë. Sipas asaj gjykate, me të drejtë organi tatimor ka vendosur ta gjobisë kërkuesen në masën 30 000 000 lekë, pasi masa e gjobës llogaritet në 300 000 lekë për çdo rast të pashoqëruar me kupon tatimor, ndaj në rastin konkret masa llogaritej veçmas për 100 tavolina.

5. Ndonëse kërkuesja ka paraqitur rekurs, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2025-13, datë 14.1.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se nuk përmbushte kërkesat e nenit 58, të ligjit nr. 49, datë 3.5.2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*Ligji për Gjykatat Administrative*).

6. Në datën 15.4.2025, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar në përputhje me parashikimet ligjore, është regjistruar në datën 22.4.2025. Kolegji i Gjykatës, me vendimin e datës 27.5.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

7. *Kërkuesja*, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se nga vendimi i Gjykatës së Lartë i janë cenuar:

7.1 *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

7.1.1 *E drejta e aksesit substancial*, pasi kërkueses nuk i është kthyer përgjigje për pretendimet e ngritura në rekurs që lidheshin me zbatimin e gabuar të ligjit material dhe mosrespektimin e praktikës gjyqësore nga gjykata e apelit.

7.1.2 *Parimi i sigurisë juridike*, pasi kërkuesja kishte pritshmëri të ligjshme nisur nga jurisprudenca e Gjykatës së Lartë në raste të ngjashme.

7.1.3 *Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, duhet të interpretonte nenin 122 të Ligjit për Procedurat Tatimore, në kushtet kur gjykatat më të ulëta kanë mbajtur qëndrime të ndryshme për zbatimin e këtij neni.

7.2 *Parimi i barazisë përpara ligjit dhe i mosdiskriminimit*, i garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi Gjykata e Lartë, në raport me raste të tjera, ka dhënë vendim diametralisht të kundërt për kërkuesen, duke e vendosur atë në një pozitë të ndryshme nga subjektet e tjera që kanë përfutur nga vendimmarrja pozitive e Gjykatës së Lartë.

7.3 *E drejta e pronës private* në aspektin procedural, e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi Gjykata e Lartë ka krijuar pasiguri juridike për kërkuesen për të rimarrë shumën e paguar të gjobës tatimore.

8. *Subjektet e interesuara, DPT-ja dhe DRT-ja*, kanë paraqitur të njëjtat argumente, duke prapësuar, në mënyrë të përmbledhur, se:

8.1 Pretendimi për cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor* nuk qëndron, pasi:

8.1.1 Nuk ka një vendim unifikues ose njëses të Gjykatës së Lartë për kuptimin e nenit 122 të Ligjit për Procedurat Tatimore, që t’i krijonte kërkueses pritshmëri të ligjshme. Vendimet e referuara nga kërkuesja kanë të bëjnë me fakte të ndryshme dhe mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit nuk hyn në juridiksionin kushtetues, ndaj janë të pabazuara argumentet për cenimin e *parimit të sigurisë juridike*.

8.1.2 Gjykata e Lartë ka argumentuar në mënyrë të qartë arsyet e mospranimit të rekursit dhe vendimi i saj plotëson *standardet kushtetuese të arsyetimit*, rrjedhimisht nuk ka cenim të këtyre standardeve.



8.2 Pretendimi për cenimin e *parimit të barazisë përpara ligjit dhe të mosdiskriminimit* është i pabazuar, sepse, sikurse është argumentuar për parimin e sigurisë juridike, mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit i përket juridiksionit të gjykatave të zakonshme.

8.3 Pretendimi për cenimin e *së drejtës së pronës* nuk qëndron, sepse procesi gjyqësor ka qenë i rregullt, pa ndonjë shkelje kushtetuese.

9. *Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit*, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se:

9.1 Pretendimi për cenimin e *procesit të rregullt ligjor* në aspektet e *parimit të sigurisë juridike dhe të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor* është i pabazuar për sa kohë nuk ka një vendim unifikues ose njësoes të Gjykatës së Lartë për çështje të kësaj natyre, ndaj kërkesja nuk mund të ketë pritshmëri të ligjshme. Gjithashtu, vendimi i Gjykatës së Lartë plotëson kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese.

9.2 Pretendimi për cenimin e *parimit të barazisë përpara ligjit dhe të mosdiskriminimit* është i pabazuar, pasi, sikurse është argumentuar për parimin e sigurisë juridike, mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit i përket juridiksionit të gjykatave të zakonshme.

9.3 Pretendimi për cenimin e *së drejtës së pronës* është i pabazuar, pasi referuar jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) mosmarrëveshjet tatimore bien jashtë fushës të të drejtave dhe detyrimeve civile, pavarësisht nga efektet monetare që ato prodhojnë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkeses

10. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo person juridik, subjekt i së drejtës private, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së

kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

11. Kërkesja, si person juridik i së drejtës private, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “F”, 134, pika 1, shkronja “I”, dhe 16, pika 2, të Kushtetutës, pasi, thelbi i të drejtave kushtetuese, që ajo pretendon se i janë cenuar (e drejta për proces të rregullt dhe ajo e pronës, si dhe parimi i barazisë përpara ligjit) përputhen me qëllimet e përgjithshme të veprimtarisë tregtare të saj. Ajo ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në ankimin kushtetues individual dhe justifikon interesin në çështjen e parashtruar.

12. Gjykata vlerëson se kërkesja e ka plotësuar edhe kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës, pasi ajo ka ngritur pretendime për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për të cilin nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të saj kushtetuese.

13. Kërkesja legjitimohet edhe *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë mban datën 14.1.2025, ndërsa ankimi kushtetues individual është dërguar nëpërmjet shërbimit postar në datën 15.4.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

14. Në drejtim të legjitimitimit *ratione materiae*, kërkesja ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në disa aspekte (akses substancial, siguri juridike dhe arsytimi i vendimit), parimit të barazisë përpara ligjit dhe të mosdiskriminimit, si dhe së drejtës së pronës, të garantuara respektivisht nga nenet 42, 18 dhe 41 të Kushtetutës. Sipas kërkeses, ajo ka paguar një gjobë të lartë tatimore dhe Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve në rekurs që lidheshin me zbatimin e gabuar të Ligjit për Procedurat Tatimore nga gjykata e apelit, qëndrimet diametralisht të kundërta të gjykatave të faktit dhe jurisprudencën e Gjykatës së Lartë në çështje të ngjashme.

15. Subjektet e interesuara i kanë prapësuar pretendimet e kërkeses si të pabazuara, duke vënë në dukje se nuk ka një qëndrim unifikues ose njësoes të Gjykatës së Lartë për çështje të ngjashme. Në shtesë të këtij prapësimi, subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka kundërshtuar edhe



juridiksionin e Gjykatës, duke mbajtur qëndrimin se mosmarrëveshjet tatimore nuk duhet të përfshihen në konceptin e së drejtës së pronës, duke referuar në funksion të këtij prapësimi një vendim të GJEDNJ-së.

16. Në jurisprudencën kushtetuese për nenin 41 të Kushtetutës është pranuar se e drejta kushtetuese e pronës private përfshin çdo posedim të sendeve ose të të drejtave të tjera materiale pasurore (*shih vendimet nr. 36, datë 21.4.2017; nr. 25, datë 28.4.2014, të Gjykatës Kushtetuese*). Edhe gjoba e caktuar për shkelje tatimore është pjesë e konceptit kushtetues të pronës private, pasi pagesa e një sasive të caktuar të hollash, e barasvlershme në këtë rast me masën e gjobave, është një shumë që merret nga pasuria e individit (*shih vendimet nr. 11, datë 21.4.2022; nr. 10, datë 4.3.2021; nr. 16, datë 25.7.2008, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim, Gjykata ka pohuar se masa e gjobës merret nga pasuria e individit, ndaj gjoba administrative përbën pronë private dhe shlyerja e saj kufizon të drejtën e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës (*shih vendimin nr. 15, datë 22.6.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, Gjykata arrin në përfundimin se prapësimi i Avokaturës së Shtetit për juridiksionin nuk qëndron, pasi detyrimet financiare që rrjedhin nga gjobat, siç është rasti konkret, përfshihen brenda konceptit kushtetues të pronës. Po kështu, Gjykata vëren se, ndryshe nga sa prapëson subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, GJEDNJ-ja, në rastin e referuar, ka pohuar se detyrimet tatimore mbrohen nga neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj, edhe pse nuk përfshihen në fushën e të drejtave civile të përcaktuara në nenin 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së (*shih Polimerkonteyner, Tov kundër Ukrainës, datë 24.11.2016, §§ 22–25*).

18. Për sa më lart, Gjykata çmon ta analizojë çështjen në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit prona private nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës private ka të drejtën e një gjykimi të drejtë (*shih vendimet nr. 11, datë 21.4.2022; nr. 10, datë 4.3.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Duke iu referuar thelbit të pretendimeve të kërkuarës, Gjykata do t'i shqyrtojë ato në themel në drejtim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e pronës. Brenda të njëjtit këndvështrim dhe për aq sa është i zbatueshëm parimi i barazisë përpara ligjit, Gjykata

do t'u japë përgjigje edhe argumenteve të palëve për qëndrimin e ndryshëm që Gjykata e Lartë ka mbajtur në çështje të tjera të ngjashme.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e pronës

19. Kërkuarja ka pretenduar se Gjykata e Lartë nuk i ka kthyer përgjigje për pretendimet e ngritura në rekurs lidhur me zbatimin e gabuar të ligjit material, si rezultat i të cilit ajo ka paguar një gjobë në vlerë tepër të lartë. Sipas kërkuarës, Gjykata e Lartë, brenda funksionit të saj, duhet të interpretojë nenin 122 të Ligjit për Procedurat Tatimore, në kushtet kur gjykatat më të ulëta kishin mbajtur qëndrime të ndryshme për zbatimin e këtij neni. Po sipas kërkuarës, Gjykata e Lartë ka dhënë një vendim diametralisht të kundërt në raport me raste të tjera të ngjashme, duke e vendosur atë në një pozitë të ndryshme nga subjektet e tjera që kanë përfituar nga vendimmarrja pozitive e kësaj gjykatë.

20. Subjektet e interesuara, DPT-ja, DRT-ja dhe Avokatura e Shtetit, kanë prapësuar se Gjykata e Lartë ka argumentuar në mënyrë të qartë arsyet e mospranimit të rekursit dhe se vendimi i asaj gjykate plotëson standardet kushtetuese të arsytimit të vendimit gjyqësor.

21. E drejta për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 12, datë 18.3.2025; nr. 20, datë 13.4.2012; nr. 7, datë 9.3.2009, të Gjykatës Kushtetuese*). Me arsyetimin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm që e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata për çështjen në gjykim (*shih vendimet nr. 10, datë 4.3.2021; nr. 18, datë 15.3.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Detyrimi për garantimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 17, datë 23.3.2023; nr. 80, datë 18.12.2017; nr. 34, datë 13.6.2016, të*



Gjykatës Kushtetuese). Arsjetimi i kufizuar i vendimeve të mospranimit të rekursit, si rregull, nuk cenon standardin e arsjetimit të vendimit gjyqësor. Megjithatë, kur në rekurs janë ngritur pretendime kushtetuese, Gjykata e Lartë, bazuar në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në shqyrtimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur lidhur me to (*shih vendimet nr. 31, datë 2.5.2025; nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 11, datë 16.4.2018, të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në vështrim të standardeve të mësipërme, Gjykata vëren se kërkuësja ka kundërshtuar vetëm vendimin e Gjykatës së Lartë, me të cilin është vendosur mospranimi i rekursit të saj. Në situatën kur rekursi nuk është shqyrtuar në themel dhe për të respektuar kufirin midis juridiksionit kushtetues dhe atij gjyqësor, Gjykata për zgjidhjen e çështjes do t'i japë përgjigje pyetjes nëse arsjetimi i kufizuar i Gjykatës së Lartë është i mjaftueshëm nga pikëpamja kushtetuese për pretendimin se mënyra e zbatimit të Ligjit për Procedurat Tatimore nga organet tatimore në caktimin e gjobës dhe më pas nga gjykatat e faktit cenon të drejtën e pronës së kërkuësës.

24. Fillimisht, Gjykata çmon të vërë në dukje përmbajtjen e Ligjit për Procedurat Tatimore. Kështu, në nenin 122, shkronja “b”, paragrafi i parë, përcaktohet se tatimpaguesi, person juridik ose fizik, tregtar, dënohet në rast se: b) nuk lëshon kupon tatimor për qarkullimin e realizuar të mallrave ose shërbimeve, për çdo rast konstatimi: i. për kontrollin e parë, me gjobë, në masën 200 000 (dyqind mijë lekë), për tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatimit mbi fitimin, dhe gjobë në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë për tatimpaguesit e tjerë, ii. për kontrollin e dytë, me gjobë, në masën 300 000 (treqind mijë) lekë, për tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatimit mbi fitimin dhe gjobë në masën 200 000 (dyqind mijë) lekë për tatimpaguesit e tjerë; iii. për kontrollin e tretë, me gjobë në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë ose mbyllje të veprimtarisë deri në 6 (gjashtë) muaj.

25. Në rastin konkret, kërkuësja ka paraqitur padi për shkak se, sipas saj, aktet administrative të nxjerra nga pala e paditur ishin në kundërshtim me nenin 122 të Ligjit për Procedurat Tatimore. Gjithashtu, sipas saj, procesverbalet e hartuara nga inspektorët tatimorë nuk pasqyrojnë gjendjen reale lidhur me

numrin e tavolinave që ishin në ambientin ku ushtrohej aktiviteti. Në rigjykimin e çështjes, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë, duke lënë si detyrim vlerën e gjobës prej 300 000 lekësh, pasi masa e gjobës duhet të ishte aplikuar për një rast konstatimi shkeljeje tatimore. Në mënyrë të përmbledhur, ajo gjykatë ka arsyetuar se, *së pari*, është i pavërtetë fakti i konstatuar nga inspektorët për gjetjen e 100 tavolinave pa kupon tatimor, pasi ato nuk ishin të gjitha në funksion në kohën e kontrollit. *Së dyti*, sipas asaj gjykate, togfjalëshi “çdo rast konstatimi” në tekstin e nenit 122, shkronja “b”, nënparagrafi “ii”, të Ligjit për Procedurat Tatimore nuk mund të interpretohet se përfshin penalizimin me gjobë për çdo tavolinë në aktivitetin tregtar në momentin e kontrollit.

26. Në të kundërt të këtij qëndrimi, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur rrëzimin e padisë, duke arsyetuar se me të drejtë organi tatimor ka vendosur ta gjobisë kërkuësen me 30 000 000 lekë, pasi provohej që në kohën e kontrollit po ofrohej shërbim në 100 tavolina pa kupon tatimor. Sipas gjykatës së apelit, organi tatimor kishte vepruar drejt, duke caktuar masën e gjobës 300 000 lekë për çdo tavolinë në funksion.

27. Ndërkohë, Gjykata e Lartë, pas shqyrtimit të shkaqeve të rekursit të kërkuësës, ka vendosur mospranimin e tij, duke lënë në praktikë të pacenuar vendimin e gjykatës së apelit. Gjykata e Lartë, me arsjetim të kufizuar, ka vlerësuar se në rekurs nuk janë parashtruar shkaqet ligjore për të cilat mund të ushtrohet e drejta e rekursit dhe as nuk evidentohen çështje ligjore që mund të shqyrtohen kryesisht nga gjykata (*shih paragrafët 16 dhe 17, të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

28. Në parantezë, Gjykata vëren se në jurisprudencën kushtetuese për nenet 155 e 157 të Kushtetutës është pranuar se parashikimi me ligj i gjobave tatimore i shërben interesit publik dhe se ligjvënësi gëzon një hapësirë vlerësimi (diskrecion) të gjerë. Sistemi tatimor luan veçanërisht rol thelbësor në rritjen dhe zhvillimin ekonomik të një vendi. Efektiviteti dhe efikasiteti i tij mund të rrezikohen nga efektet e ekonomisë informale, e njohur ndryshe si “ekonomia gri ose në hije”. Për këtë arsye, sistemi tatimor, krahas të drejtave dhe detyrimeve të palëve, duhet të përmbajë edhe mekanizma, siç janë gjobat tatimore, që nxisin subjektet ekonomike të përfshihen në procesin e



formalizimit (*shih vendimin nr. 33, datë 8.6.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Gjykata konstaton se rekursi i kërkueses nuk lidhet me caktimin e gjobës në vetvete, por me mënyrën sesi gjykata e apelit kishte interpretuar ligjin, që rezultoi me një vlerë tepër të lartë gjobe. Ajo gjykatë arriti në përfundimin se neni 122, pika 1, i Ligjit për Procedurat Tatimore zbatohet për çdo rast (tavinë) të konstatuar pa kupon tatimor dhe jo vetëm një herë. Me fjalë të tjera, rekursi i kërkueses kishte të bënte me një shkelje potenciale të së drejtës kushtetuese të pronës në drejtim të proporcionalitetit të vlerës së gjobës. Pavarësisht kësaj, Gjykata e Lartë vendosi mospranimin e rekursit pa i dhënë përgjigje të shprehur pretendimit vendimtar për zgjidhjen e çështjes, që për shkak të diferencës domethënëse të vlerës financiare (100-fish), kërkonte vëmendje të shtuar prej saj. Thënë kjo, interpretimi diametralisht i kundërt nga gjykatat e faktit i nenit 122 të Ligjit për Procedurat Tatimore dhe mosdhënia e një përgjigjeje përfundimtare nga Gjykata e Lartë për mënyrën e zbatimit të ligjit, ka bërë që, në thelb, pretendimi kushtetues i kërkueses të mbetet i pazgjidhur.

30. Gjykata vëren se kërkuesja ka sjellë në vëmendje të saj edhe qëndrimin e ndryshëm që Gjykata e Lartë (Kolegji Administrativ) ka mbajtur në katër raste të ngjashme, në të cilat është pohuar se qëllimi i Ligjit për Procedurat Tatimore është t'i disiplinohet bizneset (qofshin ato të vogla ose të mëdha) dhe jo t'i vendosë ato në pamundësi për të shlyer detyrimet tatimore, prandaj koncepti për çdo rast konstatimi duhet kuptuar se nëse nga inspektorët tatimorë në një biznes të tillë konstatohet edhe një klient i papajisur me kupon tatimor, atëherë subjekti që ka detyrimin për të lëshuar kuponin tatimor duhet të dënohet sipas parashikimeve të bëra në nenin 122, pika 1, të Ligjit për Procedurat Tatimore vetëm një herë me gjobë, e cila është e parashikuar nga kjo dispozitë dhe jo duke e shumëfishuar gjobën në bazë të tavolinave që janë të papajisura me kupon tatimor (*shih vendimet nr. 00-2024-5392, datë 12.12.2024; nr. 00-2023-3601, datë 21.9.2023; nr. 00-2016-3389, datë 21.12.2016; nr. 00-2015-2898, datë 25.6.2015, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

31. Për sa më lart, Gjykata evidenton se në vendimin e gjykatës së apelit mungon tërësisht vlerësimi ligjor për proporcionalitetin e vlerës së gjobës, pasi ajo gjykatë ka arsyetuar me terma të

përgjithshëm dhe ka nxjerrë përfundimin se veprimet e inspektorëve tatimorë ishin në përputhje me ligjin, në dallim nga gjykata administrative e shkallës së parë që ka dhënë arsye të detajuara për zgjidhjen që i ka dhënë çështjes, bazuar në rrethanat konkrete që janë provuar në gjykim. Në këtë situatë, Gjykata çmon se vendimi i Gjykatës së Lartë në rastin e kërkueses nuk ka përmbushur standardin kushtetues të arsytimit, për shkak se nuk i është dhënë përgjigje pretendimit me natyrë kushtetuese. Ky i fundit lidhet me të drejtën kushtetuese të pronës, konkretisht në drejtim të raportit të drejtë që duhet të ekzistojë midis qëllimit për mbrojtjen e interesit publik për mbrojtjen e sistemit tatimor nga informaliteti përmes caktimit të gjobës në vlerën prej 30 000 000 lekësh dhe mbrojtjes të së drejtës themelore të pronës së kërkueses. Kur individ ngarkohet me barrë të tepruar, atëherë prishet ekuilibri që duhet të ekzistojë midis interesave që synon të mbrojë parimi i proporcionalitetit. Gjykata thekson se të drejtat themelore duhet të interpretohen në atë mënyrë që të jenë efektive (*shih vendimin nr. 5, datë 2.3.2011, të Gjykatës Kushtetuese*), pasi në të kundërt rezultati mund të mos pajtohet me qëllimin e Kushtetutës, që është mbrojtja e të drejtave që nuk janë teorike ose iluzore, por praktike dhe efektive. Kjo do të thotë se vlerësimi i gjykatës së apelit duket se ishte tepër i ngushtë dhe formal, për rrjedhojë arsytimi i kufizuar i Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit bëhet i pamjaftueshëm nga pikëpamja kushtetuese.

32. Gjykata, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, rritet rolin e pazëvendësueshëm të Gjykatës së Lartë, së cilës i përket detyra kushtetuese për të siguruar njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore. Ajo gjykatë nuk ka asnjë pengesë të zgjidhë vetë çështjen ose të orientojë zgjidhjen e saj nga gjykata më e ulët, duke njësuar e zhvilluar edhe praktikën gjyqësore në përputhje me standardet kushtetuese të trajtuara në këtë vendim.

33. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimet e kërkueses janë të bazuara, sipas arsytimit të mësipërm, ndaj kërkesa pranohet.



PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2025-13, datë 14.1.2025, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 17.2.2026.

Shpallur më 10.3.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Sandër Beci, Sonila Bejtja, Marjana Semini, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marsida Xhaferllari, Asim Vokshi

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 176 lekë

